



TRANSPARENCA

E SEKTORIT TË SIGURIMIT NË

MAQEDONI

Andreja Bogdanovski
Cvete Koneska

TRANSPARENCA E SEKTORIT TË SIGURIMIT NË **MAQEDONI**

Andreja Bogdanovski
Cvete Koneska

Botues

Analytica Think Tank

www.analyticamk.org

Dame Gruev 7/8-3, 1000 Shkup, Maqedoni

Tel/Fax: +389 2 312 1948

e-mail: info@analyticamk.org

Autorë

Andreja Bogdanovski

Magdalena Lembovska

Dizajni

Muhsin Güler

Ky publikim u zhvillua fillimisht si pjesë e projektit hulumtues “Ndërtimi i Kapaciteteve të Shoqërisë Civile në Hartimin dhe Monitorimin e Reformimit të Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor, 2009 – 2011”. Ky projekt rajonal përfshinte 7 rajone të organizatës think-tank nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia dhe u mbështet financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Norvegjisë. Ai është zhvilluar në bashkëpunim me Qendrën e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) (www.dcaf.ch). Metodologjia e hartimit dhe monitorimit të reformës së sektorit të sigurisë është zhvilluar nga Qendra e Beogradit për Politikën e Sigurisë (www.bezbednost.org). TKy publikim është mbështetur financiarisht nga DCAF.



© Të drejtat janë të rezervuara 2012

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet apo të ndryshohet pa pëlqimin paraprak nga autorët.

AUTORËT

Andreja Bogdanovskit ka punuar si një hulumtues i Sigurimit në Analytica Think Tank që nga viti 2009. Ai ka një diplomë master në Shkenca Politike nga Universiteti i Parë Privat FON në Shkup. Hulumtimi i tij aktual fokusohet në reformat në sektorin e sigurisë në Maqedoni (institucionet e pavarura shtetërore dhe kontrollin ekzekutiv). Përveç kësaj, ai gjithashtu punon në transformimin e konflikteve në Ballkanin Perëndimor dhe, në veçanti, në vlerësimin e shkallës në të cilën rajoni po shkon drejt një komuniteti të sigurisë. Bogdanovski është autor i disa studimeve që lidhen me qeverisjen demokratike dhe reformën e sektorit të sigurisë në Maqedoni.

Ai mund të kontaktohet në:

abogdanovski@analyticamk.org ose
bogdanovski.a@gmail.com

Cvete Koneska ka punuar si Partner në Sigurinë dhe Përafërmin në BE të Analytica Think Tank ndërmjet viteve 2007 dhe 2009. Ajo mban një diplomë doktorature në Politikë nga Kolegjin St. Anthony, Universiteti i Oksfordit, si edhe një diplomë magjistrature në Politikë, Sigurisë dhe Integrim nga Kolegji Universitar në Londër. Hulumtimi i saj është i përqendruar në shoqëritë e ndara dhe institucioneve post-konfliktuale, si edhe transformimet post-socialiste në shtetet e ish-Jugosllavisë.

Ajo mund të kontaktohet në:

ckoneska@analyticamk.org

TABELA E PËRMBAJTJES:

Lista e shkurtesave	8
Parathënie	9
Transparenca e përgjithshme	
Përmbledhje zbatuese	11
1] Qasja ndaj informatave të rëndësishme publike	12
A] Legjislacioni	12
B] Implementimi	14
C] Kapaciteti administrativ	18
D] Vlerat	19
2] Mbrojtja e të dhënave personale	20
A] Legjislacioni	20
B] Implementimi	21
C] Kapaciteti administrativ	23
D] Vlerat	25
3] Mbrojtja e të dhënave të klasifikuara	26
A] Legjislacioni	26
B] Implementimi	28
C] Kapaciteti administrativ	30

TRANSPARENCA

E SEKTORIT TË SIGURIMIT NË

MAOEDONI

D] Vlerat	32
Rekomandime	34
Bibliografia	35
Transparenca financiare	
Përmbledhje zbatuese	40
Tabela me gradë	41
1] Transparenca financiare e procesit të buxhetimit	42
A] Legjislacioni	42
B] Implementimi	44
C] Kapaciteti administrativ	46
D] Vlera	47
2] Transparenca financiare e sigurimit publik	48
A] Legjislacioni	48
B] Implementimi	49
C] Kapaciteti administrativ	50
D] Vlera	51
Rekomandime	53
Bibliografi	54

↳ Lista e shkurtesave

ARM – Ushtria e Republikës së Maqedonisë

ESPP – Sistemi elektronik për sigurim Publik

EU – Bashkimi Evropian

IA – Agjencia për Inteligjencë

MoD – Ministria e Mbrojtjes

MoF – Ministria e Financave

Mol – Ministria e Punëve të Brendshme

PPB – Byroja e Sigurimit Publik

SAO – Zyra e kontrollimit shtetëror

UBK – Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim-inteligjencë

↳ Parathënie

Edhe njëzet e një vjet pas pavarësisimit të Maqedonisë dhe kualifikimit për anëtarësim në NATO, sektori i saj i sigurisë ende tregon dyshime rreth nevojës për transparencë, përgjegjshmëri dhe angazhim me publikun gjatë zbatimit dhe krijimit të politikave të sigurisë. Dikush mund të argumentojnë se kjo është një sjellje mjaft “normale” duke pasur parasysh se edhe dy dekada pas shpërbërjes së Jugosllavisë vendi vazhdoi ta zbatojë një kulturë të fshehtë të trashëguar nga regjimi i mëparshëm. Disa ithtarë përkrahin sektorin e fshehtësisë, pasi që një sektor i tillë i mirëmbajtur ofron siguri më të madhe dhe i zvogëlon gjasat për ndërhyrje. Është mëse e qartë se një nga funksionet e tij është ruajtja e informatave të ndjeshme. Siç u argumentua në këtë shkrim politik, kjo fushë në Maqedoni, me përjashtime të caktuara, dëshmon që përmbush detyrat siç duhet, e sidomos kur bëhet fjalë për informacionet e klasifikuara. Transparenca financiare, gjithashtu, mund të shërbejë si një tjetër shembull i mirë ku niveli bazë i transparencës është i siguar, gjatë furnizimeve lidhur me sigurinë.

Qëllimi i këtij shkrimi është ndriçimi i rrugëve kryesore ku transparenca dhe përgjegjshmëria plotësojnë fshehtësinë në sektorin e sigurisë maqedonase dhe të ofrojë një shqyrtim kritik në pesë fusha: qasjen në informata të rëndësishme publike, mbrojtjen e të dhënave private, mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara, transparencën financiare në procesin e buxhetimit dhe transparencën financiare të furnizimeve publike

Çështjet e paraqitura në këtë publikim janë rezultat i një projekti tre vjeçar: “Ngritje e kapaciteteve të shoqërisë civile që të hartohen dhe monitorohen reformat në sektorin e sigurisë në Ballkanin perëndimor”, i udhëhequr nga një partneritet i shtatë ekspertëve në Ballkanin perëndimor. Projekti botoi disa gazeta politike: 1) Almanak rreth reformave në sektorin e sigurisë në Ballkanin perëndimor, 2) Analizim kontekstual i reformave në sektorin e sigurisë në Ballkanin perëndimor, 3) Politikat e sigurisë në Ballkanin perëndimor, 4) Drejt gjeneratës së dytë të reformave në sektorin e sigurisë në Maqedoni.

Hulumtimi, kryesisht, është i bazuar në një metodologji,¹ e cila është zhvilluar nga qendra e Beogradit për politikë të sigurisë dhe është zgjeruar më tej nga gjashtë organizata të tjera ekspertësh që punojnë në këtë projekt (duke përfshirë Analytica-n). Shumica e të dhënave të mbledhura për këtë botim janë të periudhës gjatë viteve 2009 dhe 2012² dhe janë krijuar gjatë intervistave cilësore me ekspertë, hartuesë të politikave dhe akademikë, si dhe anëtarë të parlamentit dhe zyrtarë qeveritarë. Të dhënat e këtij publikimi janë marrë gjithashtu edhe nga të dhënat e përfituara duke përdorur ligjin për qasje të lirë në informatat e karakterit publik.

Ne do të donim të falënderojmë qendrën e Gjenevës për kontroll demokratik të forcave të armatosura (KDFA) për mbështetjen e dhënë dhe qendrën e Beogradit për politikë të sigurisë për menaxhimin e projektit dhe pajisjen me opinione të vlefshme. Përveç kësaj, ne do të dëshironim të shprehim mirënjohjen tonë për Dr. Snezhana Mojsoska, e cila ka dhënë mendimet e saj të vlefshme dhe njohuritë e jashtme speciale në versionet e hershme të botimit. Së fundi ne dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë për Milka Ivanovska, një ish-praktikant i Analytica që ka punuar në mënyrë të veçantë në procesin e mbledhjes së të dhënave.

Rekomandimet e ofruara në fund të këtij publikimi do të krijojnë zbatueshmëri shtesë të këtij studimi të politikave duke synuar hartuesit e politikave si dhe publikun në një përpjekje për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë në sektorin maqedonas të sigurisë.

1* Informata më të detajizuara rreth metodologjisë mund të gjinden në "Almanakun e reformave në sektorin publik në Ballkanin perëndimor" f. 241, në dispozicion në: http://www.analytica.mk/images/stories/files/ALMANAC_FINAL_WEB2.pdf

2* Të dhënat për kapitullin e transparencës financiare janë të viteve 2009 – 2010.

TRANSPARENCA E PËRGJITHSHME

↳ Përmbledhje ekzekutive

E kuptuar si një efekt anësor i demokracisë, hapja e institucioneve shtetërore ndaj qytetarëve në Maqedoni është forcuar dhe organizuar në mënyrë normative me miratimin e ligjit për qasje të lirë në informatat e karakterit publik në vitin 2006. Vendit i duheshin 16 vjet që të miratojë një zgjidhje gjithëpërfshirëse ligjore që do t'u mundësojë qytetarëve qasje të lirë në informata, edhe pse kushtetuta e ka njohur atë si një e drejtë që nga viti 1991. Menaxhimi i të dhënave personale dhe informatave të klasifikuara gjithashtu është vënë në rendin e ditës në vitet e fundit me miratimin e akteve normative përkatëse.

Konkluzioni kryesor i hulumtimit tregon se, duke folur në mënyrë normative, të trija fushat (qasje në informata, mbrojtja e të dhënave të klasifikuara dhe mbrojtja e të dhënave personale) kanë ligje të cilat janë përshtatur më tej me legjisllacionin dytësor dhe se nuk ka ndonjë dallim të madh mes tyre. Një karakteristikë e të trija fushave është krijimi i komisioneve / drejtorive të cilët do kenë për detyrë ndjekjen e zbatimit të ligjeve. Kështu, ato raportojnë parregullsi dhe i rregullojnë ato, duke konfirmuar përfitimet nga këto ligje dhe detyrimet e institucioneve të sigurisë në mesin e publikut të gjerë. Të gjithë kanë kompetenca të mjaftueshme që i japin atyre bazë të fortë për të monitoruar dhe për të vepruar rreth parregullsive. Në praktikë, sanksionimi mbetet i rastësishëm, si rezultat i risive që këto zgjidhje ligjore sjellin. Në rastin e qasjes së lirë në informata, koha e nevojshme për miratimin e plotë dhe njohjen e kësaj të drejte publike nga institucionet shtetërore ka qenë e konsiderueshme. Një shembull i mundshëm për të ndjekur është drejtoria për sigurinë e informacioneve të klasifikuara, ku kontrollimet e rregullta janë duke u zhvilluar.

Të tre komisioneve / drejtorive u mungojnë fondet përkatëse dhe, deri në një shkallë të caktuar, edhe kapacitetet administrative. Kjo e bën zbatimin e dispozitave ligjore një përpjekje të vështirë. Këto mangësi janë të theksuara sidomos në disa fusha, si trajnimet dhe sanksionet. Në rrethana të tilla, ku trajnimi mbetet i kufizuar, politizimi i administratës publike pengon cilësinë e zba-

timit, pasi që ndodhin ndryshime të shpeshta në personel.

Përveç kësaj, publiku tregon një mungesë të vetëdijes, sidomos në lidhje me qasjen e lirë në informata, kështu duke mos u bërë ndonjë shtypje institucioneve për performancë më të mirë. Një problem i madh që është identifikuar në promovimin e lirisë së qasjes në informata është mundësia e institucioneve shtetërore që të kategorizojnë dokumente të caktuara në grupin e dokumenteve me “përdorim të kufizuar”, gjë që nuk përfaqëson një nivel të klasifikimit, por parandalon qasjen e publikut në informata.

Në mënyrë që të parandalohen zyrtarët të mos fshehin informata, ndryshimet në ligjin për qasje të lirë në informata përmbajnë një “test dëmi”, i cili bëri të detyrueshëm vlerësimin se qasja apo mosqasja e publikut në ndonjë informata të caktuar do të ishte më e dobishme për ta. Në rast se vlerësohet se qasja do të ishte më e dobishme, atëherë, informata e tillë do të bëhet e hapur për publikun. Fatkeqësisht testi nuk është përdorur shpesh, dhe duhet të miratohen rregullore dhe procedura për të udhëhequr zbatimin e tij.

1] Qasja në informata të rëndësisë publike

A] Legjislacioni

Arkitektura e përgjithshme e “qasjes së lirë në informata” është ndërtuar mbi themelet e ligjit për qasje të lirë në informatat e karakterit publik (2006), ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (2005) dhe ligjit për të dhënat e klasifikuara (2004). I gjithë legjislacioni sekondar (aktet nënligjore) lidhur me lirinë e qasjes në informata është në rregull.³ Datat e miratimit të këtyre ligjeve tregojnë risitë në konceptin e qasjes së lirë në informata në Maqedoni.

³* Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata publike – Raporti vjetor 2010. Mars 2011, f. 2, në dispozicion në: http://www.komspi.mk/Content_Data/Baneri/godish-en_izveshtaj_na_komisijata_za_zashtita_na_pravoto_za_sloboden_pristap_do_informaciite_od_javen_karakter_za_2010.pdf

Para miratimit të ligjit për qasje të lirë në informata, procesi për arritjen në informacionet publike ishte i komplikuar për shkak të procedurave të ndryshme të miratuara nga institucionet e ndryshme shtetërore. Përveç kësaj, mekanizmat funksional të ankesave nuk ishin në rregull, kështu që në praktikë, marrja e informacioneve publike nuk ishte e lehtë. “Para miratimit të ligjit për qasje të lirë në informata, slogani i cili ishte përhapur ishte “Unë kam nevojë të di”, ndërsa pas miratimit të ligjit është ndryshuar: “Unë kam të drejtë të di”. Me fjalë të tjera kjo do të thotë që ju nuk keni nevojë të sqaroni pse ju duhet një informatë e caktuar.”⁴

Që nga miratimi i tij në vitin 2006, ligji për qasje të lirë në informatat e karakterit publik është ndryshuar dy herë. Në thelb, ligji duhet t’i bëjë institucionet publike më transparente dhe të përgjegjshme për publikun e gjerë. Megjithatë, ekzistojnë mekanizma të caktuara mbrojtëse që e bëjnë tekstin të paqartë dhe si i tillë ofron mundësi për të anashkaluar detyrimet e përcaktuara në ligj.

Sipas ligjit aktual “informatat me karakter publik” paraqesin çdo informatë që tashmë është e krijuar nga poseduesi i informatës apo nga ndonjë institucion (neni 3, paragrafi 2). Në praktikë, kjo tregon se në qoftë se nuk ka asnjë informatë të tillë të krijuar tashmë, atëherë kërkesa mund të refuzohet. Kjo do të thotë se institucionet nuk janë të detyruar që të angazhojnë personel shtesë që të krijojnë informatat e kërkuara (analizojnë ose përpunojnë të dhënat). Kështu që, hetimi se nëse poseduesi i informatave me të vërtetë nuk e posedon një informatë të caktuar mund të jetë një proces i gjatë që përfshin shumë aktorë të ndryshëm, si komisionin për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik, institucionin ku kërkesa është dërguar dhe gjykatat përkatëse.

Ligji për të dhënat e klasifikuara njih vetëm një kategori të dokumenteve “për përdorim të kufizuar”, e cila nuk dështon në vetvete në krahasim me pesë kategoritë e ndryshme të informatave të klasifikuara (shih pjesën e diskutimit rreth informatave të klasifikuara), të cilat nuk janë publike (ligji për informatat e klasifikuara, neni 10). Lidhur me këtë, ekziston një mungesë harmonie e dukshme në ligjin për qasje të lirë në informata, i cili përmend vetëm dokumentet e klasifikuara kur flet për mundësinë e kufizimit të qasjes në informatat publike.

⁴* Intervistë me Cveta Trajkovska, Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata publike – intervistë e realizuar më 07.11.2011

Ligjërisht, duke shfrytëzuar të ashtuquajturin “testin e dëmit” edhe informatat e klasifikuara mund të jenë të hapura për publikun, nëse poseduesi i informatave vlerëson se duke vepruar në këtë mënyrë publiku do të përfitojnë më shumë se në qoftë se kjo informatë është e fshehur. Përveç kësaj, ligji parashikon mundësinë për qasje të pjesshme në informata, kur disa elemente të caktuara janë të klasifikuara. Këto pjesë mund të fshihen ose të hiqen nga teksti.

Një komision i specializuar, i cili ka për detyrë ndjekjen e zbatimit të ligjit për qasje të lirë në informata është themeluar në vitin 2006. Një shqetësim i rëndësishëm është mungesa e kompetencave në sanksionimin e atyre që shkelin ligjin.⁵ Sipas rregullores aktuale, komisioni mund të merret me ankesat / të kryejë vizita në terren dhe të vlerësojë nëse poseduesi i informatave ka pasur ndonjë konflikt me ligjin. Në rast se ndodh një gjë e tillë, komisioni ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje në gjykatën themelore. Deri tani nuk është paraqitur një kërkesë e tillë, pasi që ligji ka filluar zbatimin menjëherë pasi u miratua nga parlamenti, kështu që poseduesit e informatave nuk kanë pasur kohë të mjaftueshme për t’u familiarizuar me ligjin.⁶

B] Zbatimi

Poseduesit e informatave kanë publikuar informata relevante dhe të hapura, si psh. strategjitë, analizat, statistikat, etj. në faqet e tyre të internetit (por edhe përmes mjeteve tjera), në përputhje me nenin 10 të ligjit për qasje të lirë në informata. Midis tre aktorëve të sektorit të sigurisë, të cilëve ky dokument u referohet,⁷ më pak transparente është Agjencia e Inteligjencës e ndjekur nga Ministria e Mbrojtjes, ku mund të gjenden vetëm të dhëna të kufizuara. Për shembull, libri i bardhë i mbrojtjes i vitit 2005 nuk është në dispozicion për shkarkim. As legjislacioni sekondar, si rregullat dhe procedurat, etj. nuk është publikuar në faqet e internetit. Ministria e Punëve të Brendshme duket se është më aktive në këtë drejtim duke publikuar të gjitha ligjet dhe legjislacionet

^{5*} Intervistë me Cveta Trajkovska, Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata publike. Intervistë e realizuar më 07.11.2011

^{6*} Ibid.

^{7*} Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia e Inteligjencës

sekondare përkatëse. Megjithatë, Ministria e Punëve të Brendshme, edhe pse jo rregullisht, publikon edhe versionet e para të ligjeve apo amendamenteve të tyre. Statistikat, raportet, studimet dhe buletinet ditore janë gjithashtu në dispozicion.

Analizat e kërkesave vjetore për informata publike tregojnë se vërehet një tendencë e rritjes sa i përket pranimit të kërkesave për informata publike.

Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Kërkesat e	513	1476	1876	2106	2379	3496

Shqyrtim i përgjithshëm i kërkesave të përgjithshme për informata publike që prej miratimit të ligjit në vitin 2006

Burimi: Fjalimi publik nga Dance Danilovska – institucioni për Shoqëri të hapur në Maqedoni.

Kjo rritje është e pranishme edhe në rastin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Shumica e kërkesave për informata publike kanë të bëjnë me të dhënat rreth krimit, trafikut, narkotikëve, punë të përkohshme, etj. Sipas MPB-së, të gjitha kërkesat që janë refuzuar kishin lidhje me informatat e klasifikuara.⁸ Ministria e Punëve të Brendshme ka formuar një departament të specializuar për informatat e rëndësisë publike, portfoli kryesor i së cilës është të punojë në zbatimin e ligjit për qasje të lirë në informata.⁹ Të dhënat tregojnë se prej vitit 2006 deri në vitin 2010 vetëm 1 nga 214 kërkesa ka të bëjë me shpenzimet e buxhetit të MPB-së dhe të tjerat 6 i referohen procedurave të furnizimeve publike.¹⁰ Duke pasur parasysh se MPB është një nga marrësit më të mëdhenj të buxhetit është e arsyeshme të pritet që një pjesë e madhe e kërkesave do të jenë rreth çështjeve të shpenzimeve buxhetore.

⁸* Të dhënat e marra duke përdorur qasjen e lirë në informata. Të zbatueshme gjatë periudhës 2006-2010.

⁹* Ibid.

¹⁰* Ibid.

Viti	2006	2007	2008	2009	2010
Kërkesat	4	44	34	63	69
Të refuzuara	2	14	2	7	5

Shqyrtim i kërkesave të përgjithshme për informatat publike, i marrë nga Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe numri i kërkesave të refuzuara për periudhën gjatë viteve 2006 – 2010.

Burimi: Ministria e Punëve të Brendshme, informata të marra nga përdorimi i qasjes së lirë në informata.

Ministria e Mbrojtjes, për periudhën ndërmjet viteve 2006 dhe 2010, ka marrë 62 kërkesa për informata publike. Kjo ministri nuk ka ndonjë departament të specializuar si në rastin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, kështu që disa persona janë të ngarkuar me kryerjen e kësaj detyre përveç portofolit të rregullt të punës së tyre. Deri tani nuk ka pasur procedura ndëshkuese të iniciuara kundër Ministrisë së Mbrojtjes ose personelit të Forcave të Armatosura për shkelje të ligjit.¹¹

Viti	2006	2007	2008	2009	2010
Kërkesat	1	9	11	23	18

Shqyrtim i kërkesave të përgjithshme për informata publike, i marrë nga Ministria e Mbrojtjes, nga periudha 2006 – 2010.

Burimi: Informata të marra nga përdorimi i qasjes së lirë në informata.

Sa i përket Agjencisë së Inteligjencës, një person është i ngarkuar me punën që ka të bëjë me kërkesat për informata të karakterit publik, por nuk ka ndonjë departament të veçantë. Deri në vitin 2011 asnjë kërkesë për informata publike nuk është dorëzuar në Agjencinë e Inteligjencës (dëshmi anekdotike).

Sipas Komisionit për mbrojtjen e qasjes së lirë në informata, një nga sfidat kryesore gjatë zbatimit të ligjit ka të bëjë me mungesën e njohurive dhe aftësive si në mesin e poseduesve të informatave, ashtu edhe në mesin e atyre që

11* Ibid.

kërkojnë informata.¹² Nuk ka asnjë informatë të veçantë për sektorin e sigurisë në lidhje me numrin e ankesave ndaj të cilave komisioni reagoi, por duke marrë parasysh ecurinë e përgjithshme të komisionit, që nga themelimi i tij në vitin 2006 deri në vitin 2010, ai ka marrë 1911 ankesa nga qytetarët, organizatat, etj. Komisioni është përgjigjur pozitivisht në shumicën e ankesave, rrespektivisht në 1480 prej tyre.¹³ Në përgjithësi, shumica e ankesave kanë të bëjnë me heshtjen e institucioneve shtetërore, mospërgjigjen ndaj atyre që kërkuan informata, ose me mosrespektimin e afatit që iu është dhënë institucioneve (40 ditë).¹⁴

Këto të dhëna në një shkallë të lartë vlejné edhe për aktorët e sektorit të sigurisë. Përvoja e Analytica-s me lirinë e qasjes në informatat e sektorit të sigurisë thekson faktin se ka sfida të ndryshme në mesin e MM-së MPB-së, dhe AI-së, kur iu përgjigjen kërkesave. Vonesat e kohëpaskohshme, të cilat janë të dukshme, mund të jenë për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative. Për shembull, kohëve të fundit Analytica pranoi një përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme për një kërkesë për informata publike, të dërguar 6 muaj më parë. Shumica e ankesave që Analytica i ka dërguar komisionit kishin të bëjnë me përgjigjen e pakënaqshme për disa kërkesa apo me shpalljen e disa prej kërkesave si informata gabimisht të klasifikuara.¹⁵ Për fat të keq, në disa raste, si psh. kur Ministria e Financave është udhëzuar nga komisioni që t'i ofrojë Analytica-s raportet vjetore rreth revizioneve të brendshme të kryera në Ministrinë e Mbrojtjes, opinioni i komisionit ishte injoruar. Mungesa e sanksionimit të drejtpërdrejtë e dobëson dukshëm pozitën e komisionit në përpjekjet e tij që të krijojë një autoritet në mesin e institucioneve shtetërore.

Testi i dëmit nuk funksionon në praktikë. Asnjë nga institucionet e sigurisë nuk e përdorin atë kur refuzojné një kërkesë për ndonjë informatë, që është informatë e klasifikuar. Kjo mund të vlerësohet si pasojë e mungesës së ekzistimit të procedurave për mënyrën se si të vlerësohet nëse deklasifikimi eventual

12* Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata publike – Raporti vjetor 2010. Mars 2011, f. 4, në dispozicion në: <http://www.komspi.mk/Content/Data/Baneri/godish-en-izveshtaj-na-komisijata-za-zashtita-na-pravoto-za-sloboden-pristap-do-informaciite-od-javen-karakter-za-2010.pdf>

13* Ibid. Faqe 2

14* Ibid. Faqe 7

15* Lexo më shumë rreth kësaj teme në paragrafin për të dhënat e klasifikuara.

i një dokumenti të caktuar është në dobi të publikut kundrejt poseduesit të informatave. Përveç kësaj, kur poseduesi i informatave zhvillon testin e dëmit, nuk është i pranishëm asnjë përfaqësues i komisionit.¹⁶ Objektiviteti i përgjithshëm kur përfaqësuesit e institucioneve vlerësojnë dëmin mund të shpjegohet më hollësisht përmes kësaj poashtu.

Kur refuzohet një kërkesë në bazë të informatave të klasifikuara dhe si rrjedhojë nëse paraqitet një apel për këtë, anëtarët e komisionit paguajnë një vizitë në terren për të vlerësuar nëse informata që ka qenë e refuzuar është në të vërtetë e klasifikuar apo është përdorur nga poseduesit e informatave si një justifikim për të mos dhënë të dhëna (dëshmi anekdotike). Kështu, anëtarët e komisionit kanë të drejtë ligjore për qasje në këto informata (niveli më i lartë - sekret shtetëror), pra qasja e tyre në informatat e klasifikuara është e plotë.¹⁷ Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes kanë dorëzuar raportet vjetore në lidhje me zbatimin e ligjit për qasje të lirë në informata. Megjithatë Agjencia e Inteligjencës ende nuk e ka bërë këtë gjë.¹⁸

C] Kapaciteti administrativ

MPB është i vetmi institucion i sektorit të sigurisë (në krahasim me AI dhe MM) që ka krijuar një departament për qasje të lirë në informata. Dy të tjerat kanë emëruar personel, pjesë e portfolit të punës së të cilëve është qasja në informata.¹⁹ Një sfidë që ka qenë e përmendur disa herë si nga komisioni, ashtu edhe në përvojën e Analytica-s, është ndryshimet e shpeshta në mesin e personave të ngarkuar me punët që kanë të bëjnë me qasjen e lirë në informata. Kjo u vu re më së shumti në Ministrinë e Mbrojtjes, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme tregon përvojë të mirë në këtë fushë. Qarkullimi i madh i të punësuarve rrjedhimisht ndikon në nivelin e arsimit dhe trajnimit në mesin e personelit. Mungesa e zyrtarëve të angazhuar vetëm me punët në lidhje me qasjen e lirë

¹⁶* Intervistë me Cveta Trajkovska, Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata publike. Intervistë e realizuar më 07.11.2011

¹⁷* Ibid.

¹⁸* Ibid.

¹⁹* Informata të marra duke përdorur qasjen e lirë në informata. Të zbatueshme në periudhën e viteve 2006-2010

në informata ndikon në performancën e përgjithshme, duke shkaktuar kështu vonesa gjatë të përgjigjurit.

Komisioni për qasje të lirë në informata përballohet me mungesën e buxhetit të mjaftueshëm për punën e tij. Buxheti i vogël ndikon drejtpërdrejtë në performancën e përgjithshme dhe sidomos në efikasitetin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me promovimin e të drejtës për qasje të lirë në informata të karakterit publik.²⁰ Ai ishte ulur në mënyrë drastike në vitin 2010, në krahasim me vitin 2009.

Viti	2008	2009	2010
Buxheti (MKD)	15.500.000	16.373.000	12.245.000

Burimi: Ministria e Financave (Faqja e internetit)²¹

Ulja e buxhetit ka ndikuar edhe në komponentin arsimor, i futur në portofolin e komisionit. Më saktësisht, komisioni nuk ishte në një gjendje që të përmbushë planin arsimor për vitin 2010.²² Nga 36 postet që komisioni duhej të ketë, vetëm 12 ishin mbushur në vitin 2010, për shkak të mungesës së financave. Sipas raportit vjetor të komisionit, numri i të punësuarve nuk është i mjaftueshëm, sidomos kur bëhet fjalë për të punësuar me kualifikime në studime juridike.²³

^{20*} Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informata publike – Raporti vjetor për vitin 2010. Mars 2011, f. 4, në dispozicion në: http://www.komspi.mk/Content_Data/Baneri/godishen_izveshtaj_na_komisijata_za_zashtita_na_pravoto_za_sloboden_pristap_do_informaciite_od_javen_karakter_za_2010.pdf

^{21*} Buxheti për vitin 2008, në dispozicion në: http://www.finance.gov.mk/files/budget_za_2008.pdf; Buxheti për vitin 2009, në dispozicion në: http://www.finance.gov.mk/files/budget_2009_final.pdf; Buxheti për vitin 2010, në dispozicion në: http://www.finance.gov.mk/files/Budzet%20na%20RM%20za%202010%20za%20objavuvaae%20%202024.12.2009_1.pdf

^{22*} Ibid.

^{23*} Ibid. Faqe 6

Dj Vlerat

Si duket qytetarët e Maqedonisë nuk kanë ende njohuri të mjaftueshme rreth të drejtës për qasje të lirë në informata. Kjo tezë është mbështetur nga një anketë e realizuar nga fondacioni Shoqëria e hapur në Maqedoni, e cila jep një vlerësim jo shumë të favorshëm. Përkatësisht, 63% e të anketuarve janë përgjigjur se ata nuk kanë njohuri rreth ligjit. Rreth 85% e të anketuarve kurë nuk kanë dorëzuar një kërkesë për një informatë me karakter publik tek ndonjë nga poseduesit e informatave.²⁴ Këto rezultate krijojnë përshtypjen se edhe disa vite pasi ligji është miratuar ende ekziston mungesë e vetëdijjes në mesin e qytetarëve për përfitimet që sjell ky ligj. Në mesin e poseduesve të informatave ekziston një ngurrim për të pranuar risitë që ky ligj sjell në konceptin e përgjithshëm të transparencës dhe të të dhënave të hapura. Kur kërkohen informata të ndjeshme, si psh. ato të lidhura me buxhetin / mbikëqyrjen / kontrollat, etj. disa prej institucioneve të sektorit të sigurisë kanë tendencë të përdorin “zgjidhje kreative” që përfundimisht do t’i bëjnë kërkuarit e informatave të heqin dorë nga kërkesat e tyre. Për shembull, kur Analytica u përpoq të marrë informata nga një institucion shtetëror i pavarur, përgjigja ishte që pyetjet ishin të pakuptimta.

24* Anketa e fondacionit Shoqëria e hapur në Maqedoni – Perceptimi i qytetarëve për të drejtën e qasjes së lirë në informata 2010. Në dispozicion në: <http://soros.org.mk/dokumenti/Istrazuvanje-na-javnoto-mislenje-za-primenata-na-zakonot-za-sloboden-pristap-vo-RM.pdf>;

2] Mbrojtja e të dhënave private

A] Legjislacioni

Kushtetuta maqedonase përmend mbrojtjen e të dhënave private në nenet 18 dhe 25, të cilat garantojnë sigurinë dhe privatësinë e të dhënave personale, si dhe mbrojtjen e integritetit personal që vjen nga përpunimi dhe regjistrimi i të dhënave të tilla. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale është miratuar në vitin 2005 dhe është ndryshuar tri herë që nga atëherë. Sa i përket kësaj çështjeje, struktura legjislative është kompletuar - duke përfshirë legjislacionin e nevojshëm sekondar.²⁵ Megjithatë, marrëveshja e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave ende nuk është nënshkruar.²⁶

Personi, të dhënat e të cilit janë përpunuar, duhet të informohet për atë aktivitet dhe duhet t'i jepet emri i personit dhe institucionit që është duke përpunuar dhe duke mbledhur ato të dhëna. Veç kësaj, personi, informatat e të cilit janë përpunuar, mund të kërkojë modifikimin dhe madje edhe fshirje të informacioneve të përpunuara. Lidhur me këtë, neni 15 i ligjit parashkruan se të drejtat e personit të cilit i përpunohen të dhënat personale mund të përjashtohen nëse, ndër të tjera, personi, ose të dhënat janë të rëndësishme për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit.

Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale ka për detyrë ndjekjen e zbatimit të ligjit, si dhe përgatitjen e legjislacionit dytësor (rregulloret etj), kryerjen e kontrolleve dhe vlerësimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, udhëheqjen e procedurave të kundërvajtjes, kryerjen e trajnimeve, sigurimin e mendimeve rreth verzoneve të para të ligjeve, etj. Drejtoria raporton parlamentin një herë në vit, përmes një raporti vjetor.

25* Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale, Raporti vjetor për vitin 2010. Mars 2011. Faqe 4. Në dispozicion në: http://dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj_2010.pdf

26* Komisioni evropian, Raporti I progresit 2011, Faqe 64. Në dispozicion në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/mk_rapport_2011_en.pdf

Nëpërmjet ndryshimeve të ligjit për të dhënat personale në vitin 2010²⁷, drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale ka përforcuar kompetencat e saj në fushën e kryerjes së kontrollimeve. Një nga ndryshimet më të dukshme ka qenë ngritja e zyrtarëve të drejtorisë, të cilët kryejnë kontrollimet, në pozitën e “inspektorëve”. Kontrollimet mund të jenë të rregullta, të jashtëzakonshme apo kontrolluese. Kontrollimet kontrolluese kryhen pas datës së skadimit, e cila është dhënë për përmirsimin e gabimeve të identifikuara. Për më tepër, inspektorëve të drejtorisë u është dhënë mundësia për qasje në premiset e ndryshme të të dhënave personale, t’i marrin në pyetje zyrtarët të cilët merren me përpunimin e të dhënave personale, dhe t’i ekzaminonjë pajisjet me të cilat janë përpunuar të dhënat, etj.

Bj Zbatimi

Raporti i progresit i BE-së për vitin 2010 vlerëson se puna e departamentit për mbrojtjen e të dhënave personale është e suksesshme.²⁸ Në vitet 2010 dhe 2011 departamenti ka dhënë disa mendime rreth projekt-amendamenteve të ligjeve, rregulloreve, etj. Ministria e Punëve të Brendshme ka kërkuar nga departamenti të japë një opinion mbi 16 ligjet (kryesisht protokolle për bashkëpunim me vendet e treta).²⁹ Përveç kësaj, departamenti për herë të parë ka zhvilluar një strategji katër vjeçare dhe një planprogram për mbrojtjen e të dhënave private.³⁰ Raporti i zbatimit të strategjisë duhet të dorëzohet së bashku me raportin vjetor të aktiviteteve të departamentit.

27* Закон за изменување и дополнување на законот за заштита на лични податоци (Ligji për ndryshimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale). Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë. Nr. 124/2010, 20 tetor 2010.

28* Komisioni evropian, Raporti i progresit 2011, Faqe 64. Në dispozicion në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/mk_rapport_2011_en.pdf

29* Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale. Raporti vjetor për vitin 2010. Mars 2011. Faqe 18&19. Në dispozicion në: http://dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj_2010.pdf dhe raporti vjetor për vitin 2011. Faqe 17&18. Në dispozicion në: http://www.dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj/Godisen_izvestaj_2011.pdf

30* Strategjia për mbrojtjen e të dhënave private 2012 – 2016. Në dispozicion në: http://dzlp.mk/sites/default/files/Strategjia_DZLP.pdf

Kontrollimet e rregullta që janë kryer nga departamenti për mbrojtjen e të dhënave personale zbatohen në bazë të programeve vjetore dhe mujore. Në fund të vitit 2011 dhe në fillim të vitit 2012 departamenti ka kryer kontrollimet e para të rregullta dymujore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.³¹ Nuk ka asnjë informacion në dispozicion për publikun në lidhje me rezultatet e këtyre kontrollimeve. Një kontrollim i jashtëzakonshëm është kryer në një stacion policor në qytetin e Shkupit në vitin 2011³² dhe dy në vitin 2010 në një stacion tjetër policor lokal në Shkup dhe në sektorin e punëve të brendshme në Strumicë.³³ Deri më tani nuk ka janë kryer kontrollime në Ministrinë e Mbrojtjes ose në Agjencinë e Inteligjencës. Megjithatë vlen të përmendet se dhjetra inspektive janë kryer në kompanitë private të sigurisë.

Në vitin 2010 shumica e vërejtjeve për zbatim më efektiv të dispozitave të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale kanë qenë të dërguara në Ministrinë e Punëve të Brendshme.³⁴ Gjatë të njëjtit vit, 16 ankesa janë paraqitur në Ministrinë e Punëve të Brendshme në bazë të shkeljes së mundshme të të dhënave personale.³⁵ Nga 16, 10 janë hedhur poshtë dhe 6 janë në procedurë.³⁶ Sipas të punësuarve të drejtorisë në periudhën mes viteve 2008 dhe nëntor 2011 drejtorja nuk ka inicuar sanksione kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë së Inteligjencës.³⁷

Në sektorin e sigurisë, vetëm Ministria e Mbrojtjes ka caktuar një zyrtar për

31* Informata të marra nga Dobrinka Borisovska – departamenti për mbrojtjen e të dhënave personale. Bisedë e realizuar më 21.11.2011

32* Drejtorja për mbrojtjen e të dhënave personale. Raporti vjetor për vitin 2011. Mars 2012. Faqe 55. Në dispozicion në: http://www.dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj/Godisen_izvestaj_2011.pdf

33* Drejtorja për mbrojtjen e të dhënave personale. Raporti vjetor për vitin 2010. Mars 2011. Faqe 60. Në dispozicion në: http://dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj_2010.pdf

34* Ibid. Faqe 22

35* Ibid. Faqe 23

36* Nga viti 2011 departamenti ka ndryshuar metodologjinë dhe përmbajtjen e raportit vjetor, kështu duke e bërë të pamundur qasjen në rezultatet e gjashtë rasteve.

37* Informata të marra nga Dobrinka Borisovska – departamenti për mbrojtjen e të dhënave personale. Bisedë e realizuar më 21.11.2011

mbrojtjen e të dhënave personale, që do të thotë Agjencia e Inteligjencës, Ministria e Punëve të Brendshme si dhe Personeli i Përgjithshëm nuk kanë një pozicion të tillë.³⁸ Veç kësaj, në faqet e internetit të MM-së, MPB-së dhe AI-së mungon informacioni se si informacionet e ruajtura në faqet e tyre të internetit janë të mbrojtura dhe se si është e garantuar privatësia e vizitorëve.

C] Kapaciteti administrativ

Një nga aktivitetet kryesore të drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale është mbajtja e trajnimeve për ata që përpunojnë dhe ruajnë të dhënat personale. Trajnimet janë organizuar në bazë të një programi vjetor të formuluar nga drejtoria. Në dy vitet e fundit drejtoria ka mbajtur dy trajnime si për çështjet e përgjithshme që kanë të bëjnë me dispozita të ndryshme ligjore, ashtu edhe për sektorë specifik, si ata që synojnë agjencitë e zbatimit të ligjit (policinë, policinë financiare, doganën dhe zyrën e të hyrave publike).³⁹

Sipas tabelës organizative të drejtorisë numri total i vendeve të parashikuara të punës është 64, megjithatë deri në fund të vitit 2011 pritet që ky numër të arrijë vetëm deri në 20.⁴⁰ Në krahasim me vitin 2010 është punësuar vetëm një person më shumë. Shumica e të punësuarve (13) kanë kryer studime ligjore. Përveç kësaj, në vitin 2011 drejtoria ka përfutuar nga puna e 4 praktikantëve. Megjithatë, në vitin 2011 drejtoria ka organizuar 9 sesione trajnime për të punësuarit, duke filluar nga transferimi i të dhënave personale në vendet e treta deri në menaxhimin e kufijve.⁴¹ Vlen të theksohet edhe se financat për kryerjen e seancave të trajnimeve burojnë nga një projekt i BE-së për përfundimin e kapaciteteve të drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale⁴²,

38* Ibid.

39* Departamenti për mbrojtjen e të dhënave personale. Në dispozicion në: <http://dzlp.mk/mk/mesecni%20planovi>

40* Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale. Raporti vjetor për vitin 2011. Mars 2012. Faqe 48. Në dispozicion në: http://www.dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj/Godisen_izvestaj_2011.pdf

41* Ibid. Faqe 50

42* 600 000 Evra pomosh od EU za direktcijata za zashita na lichnite podatoci (600 000 euro ndihmë nga BE për drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale) Kapital. 14 qershor

gjë që tregon se drejtorja duhet të punojë në vetë-qëndrueshmërinë financiare. Sa i përket kësaj, drejtorja për mbrojtjen e të dhënave personale ka dyfishuar sasinë e financave të marra nga buxheti i shtetit në krahasim me vitet e mëparshme. Kjo mund të jetë rezultat i rritjes së fluksit të financave që vijnë nga tarifat që paguajnë organizata të ndryshme për të ndjekur trajnimin për mbrojtjen e të dhënave personale. Sipas përfaqësuesit të drejtorisë buxheti ende nuk është i mjaftueshëm.⁴³

Viti:	2009	2010	2011
Buxheti (MKD):	15.547 000	14.523 000	36.464 000

Burimi: Ministria e Financave (Faqja e internetit)⁴⁴

Dj Vlerat

Fakti që Ministria e Punëve të Brendshme, Personeli i përgjithshëm dhe Agjencia e Inteligjencës ende nuk kanë caktuar një zyrtar për mbrojtjen e të dhënave personale paraqet perceptimin e tyre dhe pranimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Drejtorja përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave personale ka për qëllim që nëpërmjet kanaleve të ndryshme ta rrisë perceptimin publik lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale. Një shembull i këtillë mund të vërehet në projektin aktual të drejtorisë dhe në të përditshmen "Nova Makedonija", që ka të bëjë me mundësinë që u ofrohet qytetarëve të bëjnë pyetje të ndryshme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale. Rritja e ndërgjegjësimit publik për çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale është shfaqur edhe pas futjes në përdorim të kamerave të sigurisë

2011 http://kapital.com.mk/mk/dneven_vesnik.aspx/69581/600_000_evra_pomosh_od_eu_za_direkcijata_za_zashtita_na_lichnite_podatoci.aspx?ild=2222&utm_source=daily.mk

43* Informata të marra nga Dobrinka Borisovska – departamenti për mbrojtjen e të dhënave personale. Bisedë e realizuar më 21.11.2011

44* Buxheti për vitin 2009, në dispozicion në: http://www.finance.gov.mk/files/budget_2009_fi-nal.pdf; Buxheti për vitin 2010, në dispozicion në: http://www.finance.gov.mk/files/Budzet%20na%20RM%20za%202010%20za%20objavuvaae%20%20%2024.12.2009_1.pdf; Buxheti për vitin 2011, në dispozicion në: http://www.finance.gov.mk/files/Budzet_na_RM_za_2011_god_ZA%20OBJAVUVANJE_13.12.2010.pdf

(CCTV) nëpër qytetin e Shkupit nga Ministria e Punëve të Brendshme. Kjo ka provokuar reagime të shumta në lidhje me mundësinë për keqpërdorimin e kamerave dhe pyetje në lidhje me përpunimin e këtyre të dhënave. Hendeku në mes të instalimit të kamerave (projekti ka filluar në vitin 2009) dhe përdorimit zyrtar të CCTV (2012) u kritikua kryesisht për shkak të faktit se publiku nuk është i bindur se kamerat nuk incizojnë vetëm trafikun dhe se përpara nuk ka pasur këso lloj incizimesh.

Polemika të tjera në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale janë ngritur me vendimin e komisionit për lustracion që të nxjerren në shesh dosjet e informatorëve që kanë bashkëpunuar me shërbimet sekrete (1944-2006) dhe si rezultat i kësaj kanë rrezikuar të drejtat themelore njerëzore të personave që kanë qenë të lidhur me shërbimet sekrete. Disa nga dosjet që janë publikuar përfshijnë madje edhe numrin e amzës. Sipas ligjit për lustracion (emri zyrtar - Ligji për kërkesat shtesë për zyrën publike) të dhënat e informatorëve që janë regjistruar si të paaftë për të punuar në postet publike nuk janë konsideruar si të dhëna personale, gjë që haptazi hap konflikt si me kushtetutën, ashtu edhe me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale deri më tani nuk ka komentuar rreth kësaj çështjeje. Vlen të përmendet se që nga pavarësia e Maqedonisë në vitin 1991 ka pasur disa raste të përgjimeve të paligjshme dhe të keqpërdorimit të pajisjeve të mbikqyrjes nga ana e shërbimeve të sigurisë shtetërore si dhe nga partitë politike. Në të gjitha rastet ka pasur shkelje të qarta të të dhënave personale.⁴⁵

45* Më tepër informata për punën e shërbimeve të sigurisë në Maqedoni mund të gjinden në: Bogdanovski A. Qeverisja intelegjente në Ballkanin perëndimor – Maqedonia si rast studimi, DCAF 2012, në dispozicion në: <http://www.dcaf.ch/Publications/Case-Studies-on-Intelligence-Governance-in-the-Western-Balkans>

3] Mbrojtja e informatave të klasifikuara

A] Legjislacioni

Ligji për të dhënat e klasifikuara, i miratuar në vitin 2004, themelon një strukturë gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe menaxhimin e të dhënave sekrete. Tre amendamente u miratuan në ndërkohë. Para miratimit të ligjit kjo çështje ishte pjesërisht e rregulluar edhe në akte nënligjore të ndryshme.⁴⁶ Ligje të ndryshme që përfshijnë punën e institucioneve të sektorit të sigurisë përmendin klasifikimin e informacioneve. Për shembull, ligji për Ministrinë e Punëve të Brendshme në mënyrë të qartë thekson se MPB-ja nuk do të publikojë informacione të klasifikuara (neni 5, paragrafi 3). Ekzistojnë edhe dispozita speciale të mbrojtjes rreth punës së drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim, veçanërisht lidhur me komunikimin e saj me komisionin parlamentar, i cili ka për detyrë të mbikëqyrë punën e saj (neni 42, paragrafi 3). Klauzolat e njëjta janë të pranishme në ligjin për policinë (neni 10 paragrafi 3), ligjin për shërbimin në ushtri (neni 19), dhe ligjin për mbrojtje (neni 139). Sa i përket informatave të Agjencisë së Inteligjencës ligji nuk i quan ato informata të klasifikuara, por më tepër përdor termin informata sekrete (neni 8).

Kodi penal maqedonas nuk përmban në vetvete vepra penale që kanë të bëjnë me shkeljen e informacionit të klasifikuar, por, megjithatë, përmban kundërvajtje të ndryshme lidhur me publikimin e informacioneve sekrete. Këtu bëjnë pjesë: spiunazhi, publikimi i sekreteve shtetërore, etj. Është e qartë se 8 vjet pas miratimit të ligjit për informacionet e klasifikuara, ka nevojë të sinkronizohen disa prej dispozitave rreth kësaj çështje. Sipas një ish-drejtori të drejtorisë për sigurinë e informacioneve të klasifikuara “institucionet shtetërore si duket nuk janë aktiv në procesin e përgjithshëm të harmonizimit të legjislacionit, sidomos kur vërehet nevojë për të ndryshuar termin sekret në krahasim me termin i klasifikuar.”⁴⁷

⁴⁶* Professor dr. Stojan Slaveski, Законско уредување на тајните информации (Rregullim ligjor i informatave sekrete), Nova Makedonija, në dispozicion në: <http://www.novamakedonija.com.mk/NewsDetal.asp?vest=325122033117&id=13&prilog=0&setlzdanie=22540>

⁴⁷* Intervistë me profesor dr. Stojan Slaveski (ish-drejtor në drejtorinë për sigurinë e informacioneve të klasifikuara). Intervistë e realizuar më 16 gusht 2012

Prandaj ekzistojnë katër lloje të klasifikimit: sekretet shtetëror (më i lartë), rreptësisht i fshehtë, i fshehtë dhe i brendshëm. Ligji aktual parashikon që informacionet e klasifikuara më të larta - sekretet shtetërore mund të klasifikohen nga zyrtarët më të lartë shtetëror (presidenti, kryeministri, kryetari i kuvendit, ministrat, etj.) Megjithatë kjo zgjidhje mund të mos jetë aq e mirë, meqë ajo iu siguron këtyre personave të drejtën për të klasifikuar një dokument si sekret shtetëror në mënyrë arbitrare.⁴⁸ Mbiklasifikim i të dhënave ekziston sidomos kur bëhet fjalë për nivelin më të ulët të klasifikimit (i brendshëm) në mënyrë që publiku nuk mund të ketë qasje. "Pjesërisht, kjo mund të jetë për shkak të mungesës së kulturës së sigurisë ose mungesës së njohurive rreth ligjit. Megjithatë, personi që klasifikon dokumente të caktuara duhet të shpjegojë arsyen e klasifikimit dhe interesat që do të cenoheshin në qoftë se një informacion është i hapur."⁴⁹

Verifikimi është i nevojshëm për ata që duan të merren me informacionet e klasifikuara. Procedurat lejojnë drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim dhe sektorin për inteligjencë dhe kundërzbulim ushtarak që në emër të drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave të klasifikuara të bëjnë kontroll të kualifikimeve të kandidatit për leje zyrtare për qasje të lirë. Ky organizim shfaq disa paleverdi, sidomos në rastet kur departamenti i kundërzbulimit ka rolin kryesor gjatë vlerësimit se nëse një person është i përshtatshëm që të merret me të dhënat e klasifikuara ose jo, proces ky, që nganjëherë mund të keqpërdoret. Teoritikisht, megjithatë, ekziston një mekanizëm mbrojtës. "Drejtori i drejtorisë për informacione të klasifikuara ka autoritet mbi drejtorinë për siguri dhe kundërzbulim dhe mbi njësinë e inteligjencës dhe kundërzbulimit ushtarak, kur është fjala për të kontrolluar nëse refuzimi apo miratimi i lejes së dikujt për qasje të lirë është bërë në mënyrë profesionale, kështu që të mos ketë bazë për dyshime të mundshme."⁵⁰

48* Professor dr. Stojan Slaveski, Законско уредување на тајните информации (Rregullim ligjor i informatave sekrete), Nova Makedonija, në dispozicion në: <http://ëëë.novamakedonija.com.mk/NeësDetal.asp?vest=325122033117&id=13&prilog=0&setlzdanie=22540>

49* Ibid.

50* Intervistë me profesor dr. Stojan Slaveski (ish-drejtor në drejtorinë për sigurinë e informacioneve të klasifikuara). Intervistë e realizuar më 16 gusht 2012

Jo çdo nivel i klasifikimit kërkon një kontroll të plotë. Sipas nenit 44 leja për qasje të lirë nuk është e nevojshme për informacionet/dokumentet që janë nën nivelin e klasifikimit të dobët - i brendshëm. Kjo zgjidhje mund të mos jetë aq e mirë duke pasur parasysh se në bazë të ligjit (neni 8) publikimi i paautorizuar i dokumenteve të klasifikuara si të brendshme do të dëmtojë *"... sigurinë publike, mbrojtjen, aktivitetet e vendit lidhur me sigurinë dhe inteligjencën dhe kundërzbulimin."*

Veç kësaj, nuk u nevojitet të gjithëve leje për qasje të lirë për të punuar me informacionet e klasifikuara. Për zyrtarët e lartë shtetëror si presidenti, kryeministri, zëvendës kryeministri, kryetari i kuvendit, kryetari i gjykatës kushtetuese dhe kryetari i gjykatës supreme nuk duhet verifikim paraprak, gjë që, për shembull, për disa deputetë është kërkuar disa herë. Të gjitha institucionet shtetërore duhet të paraqesin një sistematizim të vendeve të tyre të punës, në të cilin duhet të tregojnë qartë se çfarë lloj certifikate është e nevojshme për pozicionin përkatës.

Drejtorja për sigurinë e informacioneve të klasifikuara, e themeluar në vitin 2004, është pika qendrore për zbatimin e politikave të ndryshme për sigurimin e të dhënave të klasifikuara. Me ndryshimet e ligjit për të dhënat e klasifikuara në vitin 2007, drejtorja e ka zgjeruar horizontin e saj të aktiviteteve duke kryer kontrollime për zbatimin e dispozitave të ndryshme që rrjedhin nga ligji për të dhënat e klasifikuara, si dhe duke udhëhequr procedurat kundërvajtëse.

B] Zbatimi

Inspektorët e drejtorisë bëjnë kontrollime me iniciativën e tyre, si dhe kur marrin një njoftim për ndonjë shkelje të mundshme lidhur me të dhënat e klasifikuara. Komisioni i veçantë për kundërvajtje (i formuar nga drejtori i drejtorisë) deri më tani është marrë me një rast të madh (në mesin e institucioneve të sektorit të sigurisë), si pasojë e dhënies së informacioneve të klasifikuara të huaja.⁵¹ Përveç këtij rasti, inspektorët e drejtorisë janë marrë edhe me një numër të vogël të rasteve lidhur me përpunimin e gabuar të të dhënave të

51* Intervistë me një përfaqësues të drejtorisë për informata të klasifikuara, e realizuar më: 14.11.2011. I intervistuari nuk zbuloi emrin e sektorit të veçantë të sigurisë.

fshehta nga institucionet e sektorit të sigurisë.⁵² Shumica e parregullsisve të identifikuara në këtë sektor kryesisht rrjedhin nga mungesa e njohurive në lidhje me ligjin për informacionet e klasifikuara si dhe procedurat përkatëse të përcaktuara me ligj.

Sa i përket kontrollimeve, që janë një nga veçoritë kryesore të aktiviteteve të drejtorisë, deri në vitin 2007 ka pasur kontrole të rregullta në sistemin e regjistrimit për dërgimin e informacioneve të klasifikuara të huaja deri tek marrësit përfundimtar - institucionet maqedonase. Kontrolle të tilla, janë bërë së paku dy herë në vit në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Që nga viti 2007 këto kontrole janë kryer edhe për informacionet e klasifikuara kombëtare.⁵³ Përveç kontrollimeve të kryera nga drejtoria, në drejtorinë për sigurinë e të dhënave të klasifikuara, si dhe në institucione tjera shtetërore që përdorin informata të klasifikuara të NATO-s bëhen kontrollime edhe nga NATO. Konkluzionet nga kontrollimet e NATO-s në vitin 2010 e vlerësojnë punën e drejtorisë me nota të larta.⁵⁴ Në vitin 2009, 2010 dhe 2011 drejtoria ka mbajtur kontrollime të rregullta në regjistrimet e informacioneve të klasifikuara të drejtorisë për sigurinë e informacioneve të klasifikuara në lidhje me misionet e Maqedonisë në NATO dhe BE.⁵⁵ Të gjitha institucionet e sektorit të sigurisë kanë caktuar zyrtarë që sigurojnë informacionet e klasifikuara.

Shumë polemika u ngritën në lidhje me procesin e verifikimit, sidomos në mesin e anëtarëve të parlamentit të cilët janë anëtarë të komisionit për mbikëqyrjen e punës së drejtorisë për siguri dhe kundërzbulim dhe agjencisë së inteligjencës, si dhe agjencisë për përcjelljen e teknikave të telekomunikacionit. Duke e ditur se drejtoria për siguri dhe kundërzbulim i kryen kontrollet e nevojshme, anëtarët e partisë opozitare kanë shprehur dyshime se nëse vonesa e dorëzimit të lejes për qasje të lirë ose mungesa e saj mund të jetë për shkak të rivalitetit politik.⁵⁶ Çështja është zgjidhur përkohësisht, duke i pajisur

52* Ibid.

53* Ibid.

54* Drejtoria për sigurinë e informacioneve të klasifikuara - <http://www.dbki.gov.mk/?q=node/177>

55* Intervistë me një përfaqësues të drejtorisë për informata të klasifikuara, e realizuar më: 14.11.2011

56* Тајните служби го владеат парламентот (Shërbimet sekrete qeverisin parlamentin) Vest 18.10.2010. në dispozicion në: <http://www.vest.com.mk/?ItemID=8C12D57DEDEB54BA13F->

anëtarët e komisioneve me leje të përkohshme për qasje të lirë.

C] Kapaciteti administrativ dhe menaxherial

Edhe pse drejtorja për sigurinë e informacioneve të klasifikuara është formuar me miratimin e ligjit për informacionet e klasifikuara në vitin 2004, ajo nuk ka filluar punën e saj nga zeroja. Para themelimit të drejtorisë, departamente të ndryshme për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara u shpërndanë nëpër aktorët kryesorë të sektorit të sigurisë që rrjedhin nga marrëveshja e sigurisë midis Maqedonisë dhe NATO-s në vitin 1996. Autoriteti i sigurimit kombëtar, i formuar si rezultat i kësaj marrëveshjeje në vitin 2002, më vonë (në vitin 2004) u zëvendësua me organin aktual. Kjo tregon se ky organ posedon një numër të madh të personelit që është trajnuar për të mbrojtur sigurinë e informatave të klasifikuara në përputhje me standardet ndërkombëtare (të NATO-s). Ndërsa dy organe tjera të pavarura (Drejtorja për mbrojtjen e të dhënave personale dhe komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat publike) janë krijuar nga parlamenti. Drejtorja për sigurinë e të dhënave të klasifikuara është një agjenci qeveritare. Kur bëjmë krahasim me institucionet e vendeve tjera dhe duke pasur parasysh se në vendet tjera këto institucione janë pjesë e institucioneve të tjera të sigurisë, struktura e Maqedonisë është shumë më e mirë.⁵⁷

Buxheti i drejtorisë është i vogël, por ajo ka mbështetje të fuqishme nga NATO.⁵⁸ Është e qartë se ka pasur një rënie në buxhetin e drejtorisë, të siguruar nga qeveria, veçanërisht në krahasim me vitin 2009, si dhe një rënie në zhvillimin profesional.

[B80AFC225CEA](#)

^{57*} Intervistë me një përfaqësues të drejtorisë për informata të klasifikuara, e realizuar më 14.11.2011

^{58*} Ibid.

Viti:	2009	2010	2011
Buxheti vjetor:	39.445.000	26.500.000	24.410.00
Zhvillimi profesional	330 000	160 000	150 000

Burimi: Ministria e Financave – faqja e internetit⁵⁹

Kah fundi i vitit 2011 (kur është realizur intervista) ka pasur 32 të punësuar që punojnë për drejtorinë. Ky numër nuk ka ndryshuar shumë në krahasim me 3 vitet e fundit (32-34). Dy prej të punësuarve punojnë në misionet e NATO-s dhe BE-së. Megjithatë ekziston nevoja për personel shtesë në këto dy institucione për shkak të vëllimit të rritur të informacioneve të klasifikuara nga Brukseli dhe Moni, për të siguruar se ka të paktën dy persona që mund të bëhen deputetë (gjë që është e kërkuar edhe nga NATO).⁶⁰ Përveç nevojës për përforcimin e kapaciteteve në misionet e Maqedonisë jashtë vendit, drejtorja konsideron të nevojshme edhe shtimin e personelit në regjistrin kombëtar, në sektorin e IT, dhe në sektorin për bashkëpunim ndërkombëtar.⁶¹ Shumica e punonjësve të tanishëm kanë punuar në drejtori që nga viti 2006 dhe kanë ekspertizë të zhvilluar lidhur me këtë fushë.⁶²

59* Buxheti për vitin 2009, në dispozicion në: http://www.finance.gov.mk/files/budget_2009_fi-nal.pdf; Buxheti për vitin 2010, në dispozicion në: http://www.finance.gov.mk/files/Budzet%20na%20RM%20za%202010%20za%20objavuvaae%20%20%2024.12.2009_1.pdf; Buxheti për vitin 2011, në dispozicion në: http://www.finance.gov.mk/files/Budzet_na_RM_za2011_god_ZA%20OBJAVUVANJE_13.12.2010.pdf

60* Интервју со претставник на Дирекцијата за безбедност на класифицирани информации, одржано на 14.11.2011.

61* Ibid.

62* Ibid.

Dj Vlerat

Edhe pse drejtoria për sigurinë e informacioneve të klasifikuara është një agjenci qeveritare, ajo paraqitet si plotësisht e pavarur duke theksuar se drejtori i drejtorisë nuk mund të jetë anëtar i ndonjë partie politike dhe se NA-TO-ja nuk toleron politizim të punës së drejtorisë, sidomos kur bëhet fjalë për dhënjen e lejes për qasje të lirë.⁶³ Mundësia e humbjes së lejes për qasje të lirë paraqet një kërcënim më të madh në krahasim me gjrobat e përcaktuara në ligj (Shënim i autorit - duke filluar nga 1000 deri në 5000 euro).⁶⁴ Nëse ndodh një gjë e tillë, personi përgjegjës mund të humbasë punën e tij në institucionet që punojnë me të dhëna të klasifikuara.⁶⁵ Ka raste kur institucionet shtetërore kërkojnë nga drejtoria informacione dhe kontrole shtesë, për t'u siguruar se ata janë duke i përpunuar informacionet e klasifikuara në përputhje me ligjin.

Përvoja e Analytica-s tregon se ende ka institucione të caktuara të sigurisë që mbështesin kulturën e sekretit, që filloi nga sistemi i kaluar. Për shembull, Agjencia e Inteligjencës në raundin e parë të pyetësorëve, që u dërguan duke përdorur lirinë e qasjes në informata, ka refuzuar shumicën e informacioneve duke u bazuar në faktin se ato janë informacione të klasifikuara. Si rezultat i ndërhyrjes së komisionit për mbrojtjen e lirisë së qasjes në informata, tani është zbuluar që ky fakt është i pavërtetë, kështu që shumë informacione janë dhënë më vonë.

Shqetësimet janë rritur pas publikimit të një dokumenti të klasifikuar nga ana e ish-presidentit Branko Cërvenkovski në një debat televiziv. Ai ka publikuar propozimet nga i dërguari special i OKB-së, në lidhje me mosmarrëveshjen rreth emrit midis Maqedonisë dhe Greqisë.⁶⁶ Zyra e prokurorit publik ka deklaruar që ai konsiderohet një dokument shumë sekret.⁶⁷ Një gazetë e përdits-

63* Ibid.

64* Ibid.

65* Ibid.

66* Црвенковски не издал државна тајна, вели Шврговски (Crvenkovski nuk ka publikuar sekret shtetëror, thotë Shvrgovski), Utrinski Vesnik 05.06.2012. Në dispozicion në: <http://www.utrinski.com.mk/default.asp?ItemID=5E3F2EC03928A0499D70D61EBF97285E>

67* Ibid.

hme kombëtare ka shqyrtuar rastin se a ka qenë dokumenti në arkivat e dokumenteve në zyrën (aktuale) të presidentit, apo jo. Më në fund është zbuluar që nuk ka qenë.⁶⁸ Ky zbulim ka shkaktuar dilemë se a kanë disa zyrtarë koleksione “private” të informacioneve të klasifikuara. Disa punonjës tashmë janë sanksionuar nga drejtoria për sigurinë e informacioneve të klasifikuara.⁶⁹

68* Приватните архиви полни со државни тајни (Arhivat private të mbushura me sekrete shtetërore) Dnevnik, 30.05.2012. Në dispozicion në: <http://daily.mk/forward/1320778/private-arhivi-polni-so-drzhavni-tajni>

69* Паднаа првите казни за злоупотреба на државни тајни за името (Sanksionet e para për keqpërdorjen e sekreteve shtetërore) Dnevnik, 05.06.2012. Ne dispozicion në: <http://dnevnik.com.mk/?ItemID=FC75569EB6ED204E84BC755F2E645ED3>

↳ Rekomandime:

- Ndryshoje dhe plotësoje ligjin për informacione të klasifikuara (neni 10), në mënyrë që nuk do lejohet kufizimi i qasjes apo edhe mosqasja në dokumente për publikun, duke lënë institucionet shtetërore në një gjendje që nuk do kenë mundësi të refuzojnë një kërkesë për qasje të lirë në informata mbi baza të tilla.
- Përgatiteni dhe miratojeni rregulloren dhe procedurat për zbatimin e testit të dëmit. Komisioni për qasje të lirë deri te informatat e karakterit publik duhet të organizojë një sërë seanca trajnimesh për institucionet shtetërore, duke i informuar ata për procedurat e aplikimit për këtë test.
- Komisioni për qasje të lirë në informacionet e rëndësishme publike duhet të krijojë një manual rreth mënyrave për të shfrytëzuar lirinë e qasjes në informata dhe për të promovuar atë në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.
- Burimet më të mëdha financiare duhet t'u përkushtohen komisioneve / drejtorisë, sidomos sektoret që kanë për detyrë kontrollin dhe sanksionimin.
- Ministria e Punëve të Brendshme, për shkak të strukturës së saj komplekse dhe numrit të madh të njësisve / sektorëve, duhet të ndajë fonde të mëdha dhe të emërojë zyrtarë që merren me qasjen në informata të karakterit publik.
- Shtabi i Përgjithshëm dhe Agjencioni i Inteligjencës duhet të emërojnë një nëpunës të të dhënave personale për mbrojtje.
- Së paku dy persona të tjerë duhet të punësohen në misionin e Maqedonisë për hyrjen në BE / NATO në Bruksel dhe në selinë e NATO-s në Mons (Shtabi Suprem i Fuqive Aleate për Evropë) për përpunimin e të dhënave të klasifikuara.
- Ligji për qasje të lirë në informatat e karakterit publik duhet të ndryshohet duke inkorporuar një sektor të sanksioneve që do t'u mundësonte atyre të vendosin sanksione në mënyrë të drejtpërdrejtë.

- Politikat e të dhënave sekrete nëpër faqet e internetit të Ministrisë Punëve të Brendshme, Mbrojtjes dhe Agjencisë së Inteligjencës duhet të bëhen publike.

↳ Bibliografia:

Устав на Република Македонија (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 52. 22.11.1992.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është ndryshuar me amendamentet vijuese: Amendamentet I dhe II (10 janar 1992); Amendamenti III (02 korrik 1998); Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII (20 nëntor 2001); Amendamenti XIX (30 dhjetor 2003); Amendamentet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX dhe XXX (09 dhjetor 2005); Amendamenti XXXI (09 janar 2009); Amendamenti XXXII (12 prill 2011).

Закон за слободен пристап до информации од јавен карактер (Ligji për qasjen e lirë në informacionet e karakterit publik). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 13/2006, 01 Shkurt 2006.

Закон за изменување на законот за слободен пристап до информации од јавен карактер (Ligji për ndryshimin e ligjit për qasjen e lirë në informacionet e karakterit publik). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 86/2008, 14 Korrik 2008.

Закон за изменување на законот за слободен пристап до информации од јавен карактер (Ligji për ndryshimin e ligjit për qasjen e lirë në informacionet e karakterit publik). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 6/2010, 15 janar 2010.

Закон за заштита на лични податоци (Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 7/2005.

Закон за изменување и дополнување на законот за заштита на лични податоци (Ligji për ndryshimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 103/2008. 19 Gusht 2008.

Закон за изменување и дополнување на законот за заштита на лични податоци (Ligji për ndryshimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 124/2010. 20 tetor 2010.

Закон за изменување и дополнување на законот за заштита на лични податоци (Ligji për ndryshimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 135/2011. 03 tetor 2011.

Закон за класифицирани информации (Ligji për të dhënat e klasifikuara). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 09/2005. 27.02.2004.

(Ligji për ndryshimin e ligjit për të dhënat e klasifikuara). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 113/2007. 20.09.2007.

(Ligji për ndryshimin e ligjit për të dhënat e klasifikuara). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 145/2010. 05.11.2010.

(Ligji për ndryshimin e ligjit për të dhënat e klasifikuara). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 113/2007. 20.09.2007.

Sondazhi FISHHM - Perceptimi i qytetarëve për të drejtën për qasje të lirë në informata <http://soros.org.mk/dokumenti/Istrazuvanje-na-javnoto-mislenje-za-primenata-na-zakonot-za-sloboden-pristap-vo-RM.pdf>; 2010

Raporti vjetor 2010 - Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacionet e karakterit publik... mars 2011 http://www.komspi.mk/Content/Data/Baneri/godishen_izveshtaj_na_komisijata_za_zashtita_na_pravoto_za_sloboden_pristap_do_informaciite_od_javen_karakter_za_2010.pdf

Raporti vjetor 2010 - Komisioni për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informacionet e karakterit publik... mars 2011 http://www.komspi.mk/Content/Data/Baneri/godishen_izveshtaj_na_komisijata_za_zashtita_na_pravoto_za_sloboden_pristap_do_informaciite_od_javen_karakter_za_2010.pdf

Raporti vjetor për 2010. Mars 2011. Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale. http://dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj_2010.pdf

Raporti vjetor për 2011. Mars 2011. Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale. http://www.dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj/Godisen_izvestaj_2011.pdf

Raporti i progresit 2011. Komisioni evropian. http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/mk_rapport_2011_en.pdf

Strategjia për mbrojtjen e të dhënave private 2012 – 2016 në dispozicion në: http://dzlp.mk/sites/default/files/Strategjija_DZLP.pdf

Raporti vjetor për 2011. Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale. Mars 2012. http://www.dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj/Godisen_izvestaj_2011.pdf

Raporti vjetor për 2010. Drejtoria për mbrojtjen e të dhënave personale. Mars 2011. http://dzlp.mk/sites/default/files/Dokumenti/Godisen_izvestaj_2010.pdf

Mediumet:

Tajните служби go vladeat parlamentot (Shërbimet sekrete qeverisin parlamentin). Vest. 18.10.2010. Në dispozicion në: <http://www.vest.com.mk/?ItemID=8C12D57DEDDEB54BA13FB80AFC225CEA>

Profesor Dr. Stojan Slaveski, Законско уредување на тајните информации (Rregullimi ligjor i informatave sekrete), Nova Makedonija, në dispozicion në: <http://www.novamakedonija.com.mk/NeësDetal.asp?vest=325122033117&id=13&prilog=0&setlzdanie=22540>

600 000 Евра помош од ЕУ за дирекцијата за заштита на личните податоци (600 000 euro ndihmë nga BE-ja për Drejtorinë për mbrojtjen e të dhënave personale). Kapital 14 qershor 2011. http://kapital.com.mk/mk/dneven_venik.aspx/69581/600_000_evra_pomosh_od_eu_za_direkcijata_za_zashtita_na_lichnite_podatoci.aspx?ild=2222&utm_source=daily.mk

Црвенковски не издал државна тајна, вели Шврговски (Crvenkovski nuk ka publikuar sekrete shtetërore, tregon Shvrgovski). Utrinski vesnik 05.06.2012. Në dispozicion në: <http://www.utrinski.com.mk/default.asp?ItemID=5E3F2E-C03928A0499D70D61EBF97285E>

Приватните архиви полни со државни тајни (Arkivat private të mbushura me sekrete shtetërore) Dnevnik, 30.05.2012. Në dispozicion në: <http://daily.mk/forëard/1320778/privatnitate-arhivi-polni-so-drzhavni-tajni>

Паднаа првите казни за злоупотреба на државни тајни за името (Sanktionet e para për keqpërdorjen e sekreteve shtetërore). Dnevnik 05.06.2012. Në dispozicion në: <http://dnevnik.com.mk/?ItemID=FC75569EB6ED204E84B-C755F2E645ED3>

Intervistat e realizuara:

Intervistë me Cveta Trajkovska-n - Komisioni për mbrojtjen e së drejtës për qasje të lirë në informacionet me karakter publik. Intervistë e realizuar më 07.11.2011.

Intervistë me Profesor Dr. Sllaveski Stojan (ish-drejtor i Drejtorisë për sigurinë e informacioneve të klasifikuara). Intervistë e realizuar më 16 gusht 2012.

Intervistë me një përfaqësues të Drejtorisë për informacione të klasifikuara, e realizuar më 14.11.2011. I intervistuari nuk e zbuloi emrin e institucionit të sektorit të sigurisë.

Të tjera:

Informacion i marrë nga Dobrinka Borisovska - Sektori për mbrojtjen e të dhënave personale. Bisedë e realizuar më 21.11.2011

TRANSPARENCA FINANCIARE

↳ Përmbledhje ekzekutive

Ky dokument shqyrton nivelin e transparencës financiare në sektorin e sigurisë në Maqedoni. Analizimi i transparencës financiare është i ndarë në dy fusha të vëzhgimit: Transparenca financiare në procesin e buxhetimit dhe transparenca financiare në furnizimet publike. Për secilin nga këto dy fusha të vëzhgimit kemi shqyrtuar gjendjen e legjislacionit në këtë fushë, nivelin e zbatimit të legjislacionit, kapacitetet administrative dhe menaxheriale të institucioneve dhe organeve përgjegjëse për zbatimin e dispozitave legjislative, si dhe shkallën në të cilën vlerat demokratike të transparencës financiare janë miratuar dhe adaptuar nga aktorët e sektorit publik.

Si në buxhetim ashtu edhe në furnizimet publike, legjislacioni kombëtar është i fortë dhe, pjesa më e madhe, është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane të kësaj fushe. Përveç ligjeve primare, shumica e legjislacionit sekondar ka qenë i adoptuar poashtu, edhe pse për disa ligje të adoptuara rishtazi ose të ndryshuar, adoptimi i legjislacionit sekondar zhvillohet ngadalë. Zbatimi i dispozitave ligjore është fragmentar, ku disa aspekte të dispozitave të transparencës financiare zbatohen më mirë dhe në mënyrë të vazhdueshme, në krahasim me të tjerët, dhe me disa programe të reja si e-buxhet dhe e-furnizime duke përparuar në arritjen e transparencës financiare. Shkelja e dispozitave të transparencës financiare megjithatë është ende e shpeshtë, por ata që janë përgjegjës, gjithnjë e më shumë, janë duke u ndjekur penalisht dhe duke u dërguar në gjykatë, siç tregohet në këtë shkrim.

Kapaciteti administrativ dhe menaxherial i organeve përgjegjëse është i ndryshueshëm. Disa institucione, si Ministria e Financave, Byroja e furnizimit publik dhe Zyra shtetërore për revizion financiar janë të njohura për kapacitet e fortë organizativ, njerëzor dhe material, ndërsa kapaciteti i transparencës financiare tek të tjerët, në Ministrinë e Mbrojtjes dhe atë të Punëve të Brendshme për shembull, sidomos në nivel lokal, është ende duke u krijuar. Adoptimi i vlerave të transparencës financiare është pika më e dobët e sektorit publik të Maqedonisë. Ato vlera demokratike janë të humbura për shkak të një arritjeje të

dobët të një zbatimi konsekuent të dispozitave të transparencës financiare dhe zbulimit të skandaleve financiare dhe të furnizimeve në institucionet e sektorit të sigurisë nga ana e mediave.

↳ Tabela me nota

Transparencës financiare në sektorin e sigurisë në Maqedoni i është dhënë nota 3. Analizimi i të dhënave që janë në dispozicion rreth kësaj teme në Maqedoni sugjeron që edhe në lidhje me buxhetimin dhe me furnizimet publike, disa standarde themelore të transparencës janë futur në legjislacionin e financave, të cilat kanë përmirsuar legjislacionin dhe punën e sektorit të sigurisë. Shumica e institucioneve iu përmbahen kërkesave ligjore, edhe pse cilësia e zbatimit ndryshon varësisht prej institucionit, dhe shumica ende kanë nevojë të tregojnë një sukses të pandërprerë të zbatimit dhe miratimit të vlerave të transparencës financiare në punën e tyre.

Notat e analizave për dy fushat e ndara, buxhetimin dhe furnizimet publike janë të elaboruara më hollësisht në tabelën më poshtë.

Fushat e vëzhgimit	Transparenca financiare në procesin e buxhetimit	Transparenca financiare në furnizimet publike	Notat e përgjithshme
Grades	3	3	3

Transparenca financiare, përveç transparencës së përgjithshme, është vendimtare për krijimin e një sektori demokratik të sigurisë. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe mbikëqyrjes parlamentare mbi buxhetin dhe proceset e furnizimeve publike, si dhe përmes qasjes publike në informata relevante dhe dokumente në lidhje me aspektet financiare të punës së sektorit të sigurisë, publiku është i informuar dhe mbulesa e fshehtësisë është larguar nga puna e aktorëve të sigurisë, ndërkohë që keqpërdorimi i fondeve dhe mashtrimi janë penguar gjithashtu. Paragrafet e mëposhtme ofrojnë një analizë të gjendjes së transparencës financiare në sektorin e sigurisë maqedonase. Buxhetimi dhe praktikrat e furnizimeve publike janë shqyrtuar duke e hartuar progresin e rradhitjes së

elementeve legislative, administrative, menaxheriale dhe normative të punës financiare me standardet demokratike të transparencës financiare në sektorin e sigurisë.

1] Transparenca financiare në procesin e buxhetimit

A] Legjislacioni

Maqedonia ka miratuar të gjitha dokumentet themelore legislative në lidhje me procesin e buxhetimit. Procesi i buxhetimit është i rregulluar përmes ligjit për buxhetet (*Gazeta zyrtare* 64/2005), i cili përmban parimet kryesore të procesit të buxhetimit. Për më tepër, një ligj vjetor mbi ekzekutimin e buxhetit, të cilin Kuvendi e pranon si buxhet, është miratuar për vitin e ardhshëm. Përveç transparencës, efikasitetit, efektivitetit dhe përgjegjshmërisë, si parime themelore buxhetore, ligji për buxhetet përmban një kapitull të veçantë rreth transparencës, duke theksuar kërkesat themelore që duhet të respektohen. Ato janë:

publikimi i buxhetit,

publikimi i raporteve gjysëmvetore dhe vjetore,

publikimi i versionit ekzekutiv të buxhetit, si dhe

publikimi i llogarive përfundimtare të Ministrisë së Financave në faqen e internetit të MF dhe në *Gazetën Zyrtare*.

Përveç publikimit të versioneve të ndryshme të buxhetit qendror dhe raporteve buxhetore, Ministria e Financave (MF) ka formuluar udhëzimet dhe formularët që çdo përdorues buxhetor ka nevojë t'i përdorë gjatë përgatitjes së buxhetit të këtij institucioni në fazën e planifikimit të ciklit buxhetor, si dhe të akteve nënligjore që rregullojnë procesin buxhetor. Sipas dispozitave të ligjit për buxhetet, MF përgatit buxhetin qendror duke u bazuar në disa dokumen-

te strategjike, duke përfshirë: prioritetet strategjike të qeverisë, strategjinë afatmesme fiskale dhe treguesit makroekonomik, të cilat janë në dispozicion për publikun në faqen e internetit të MF.

Për hir të transparencës dhe mbikëqyrjes, buxheti qendror, dhe më pas buxhetet e çdo institucioni buxhetor janë ndarë në kategori: buxheti bazë, buxheti i donacioneve, buxheti kreditor dhe buxheti i aktiviteteve të vetë-financuara, varësisht nga natyra e burimeve dhe të ardhurave. Në këtë mënyrë ndjekja dhe raportimi i shpenzimeve të fondeve nga burime të ndryshme - buxheti i shtetit, burimet e veta, donacionet - është bërë e lehtë dhe kështu është bërë e lehtë edhe ndjekja e revizione financiare pasuese.

Megjithatë, edhe pse dokumentet dhe udhëzimet për përgatitjen e buxhetit janë në dispozicion, faza e planifikimit të buxhetit nuk është e njohur për publikun pasi që nuk ka arsye përse popullata të shohë apo të komentojë rreth projektit të buxhetit - që do të thotë, nuk ka buxhet për qytetarët. Ky është një veprim mjaft i zakonshëm në demokracitë më të zhvilluara, e cila lejon qytetarët të gjykojnë se si qeveritë e tyre janë duke planifikuar shpenzimet dhe kjo kontribuon në financim publik më të përgjegjshëm dhe pjesëmarrës. Për më tepër, në rastin e ristrukturimit të buxhetit, si për shembull gjatë vitit 2010, kur shumata e caktuara janë ndryshuar brenda një viti të vetëm buxhetor, publiku nuk është konsultuar rreth natyrës së ndryshimeve dhe prioriteteve të tyre sa i përket temave buxhetore.

Ligji për buxhetet rregullon rolin e parlamentit në procesin e buxhetimit. Parlamenti miraton propozimin për buxhetin vjetor, të cilin qeveria e dorëzon nga 15 nëntor çdo vit. Komisioni për buxhet dhe financa (KBF) shqyrton propozimin e buxhetit, i cili debatohet më pas në një seancë plenare, para se të miratohet apo të kthehet në qeveri për ndryshime. Parlamenti gjithashtu merr llogarinë finale nga qeveria, së bashku me raportin nga Zyra shtetërore të revizionit financiar, dhe shqyrton ekzekutimin e buxhetit. Së fundi, parlamenti duhet të miratojë çdo ndryshim në buxhet që tejkalon 5% të të ardhurave dhe shpenzimeve.⁷⁰

Zbatimi i buxhetit është i kontrolluar nga Zyra shtetërore e revizionit financiar (ZSHR), e cila publikon deklaratat vjetore të revizioneve financiare të buxhetit

⁷⁰* Закон за буџетите (Ligji për buxhetet) në Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë. (Nr. 64/05) 3 gusht 2005.

qendror dhe kontrollon punën financiare dhe performancën e qeverisë dhe organeve publike, përfshirë edhe aktorët e sektorit të sigurisë, siç janë Ministria e Mbrotjtjes (MM), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Agjencia e Inteligjencës (IA), etj. Ligji i fundit për revizion shtetëror (*Gazeta Zyrtare* 66/2010) u miratua në vitin 2010 dhe arrin standardet më të larta ndërkombëtare për revizion dhe kontroll financiar, duke përfshirë dispozitat për transparencën e punës së ZSHR. ZSHR gjithashtu ka qasje në të dhënat e klasifikuara, ku disa nga buxhetet e aktorëve të sigurisë do jenë pjesë e kësaj kategorie, si dhe revizorët shtetërorë, të cilët duhet të kalojnë nëpër procedurën e certifikimit të sigurisë të përcaktuar në ligjin për të dhënat e klasifikuara (*Gazeta Zyrtare* 4/9) në mënyrë që të hyjnë në këto të dhëna. Revizorët përgatisin një raport të veçantë rreth të dhënave të klasifikuara, i cili është trajtuar përmes procedurave lidhur me të dhënat e klasifikuara dhe publiku ka qasje të kufizuar në të.

B] Zbatimi

Në përgjithësi, zbatimi i dispozitave të transparencës financiare, të përcaktuara me ligjin për buxhetet dhe legjislacionet e ndryshme, është i fortë. MF publikon buxhetin, raportet e revizioneve dhe deklaratat financiare vjetore në faqen e saj (www.finance.gov.mk) dhe në Gazetën zyrtare. Përveç kësaj, Ministria e Financave ka gjithashtu një arkiv 3 vjeçar të të gjitha dokumenteve buxhetore, duke përfshirë bilancin e fundvitit, buxhetin dhe projektin e buxhetit, ligjet vjetore për zbatimin e buxhetit dhe ndryshimet dhe plotësimet eventuale në buxhet. Përveç kësaj, faqja e internetit të MF-së gjithashtu përmban një pjesë rreth legjislacionit dhe rregulloreve të buxhetit, i cili përmban ligjet dhe udhëzimet për përgatitjen e buxhetit (klasifikimi për të ardhurat dhe shpenzimet) për përdoruesit e buxhetit.

Me qëllim që të rrisë efikasitetin dhe transparencën, në vitin 2008, Ministria e Financave kyçi një aplikacion elektronik, të quajtur e-buxhet, për disa përfituesë të buxhetit. Ky aplikacion duhet të bëjë më të lehtë procesin e buxhetimit për ata përfituesë buxhetorë që janë të pajisur me detaje rreth përdorimit si dhe me udhëzime se si të përdoret ky aplikacion, dhe përmban të gjitha format

dhe dokumentet që përdoruesit e buxhetit (organe të ndryshme publike dhe institucione) përdorin gjatë ciklit buxhetor. Të gjitha organet publike kanë qasje në dokumentet e ofruara nga përdoruesit e tjerë buxhetorë, gjë që e bën procesin buxhetor më të hapur dhe më të lehtë për të mbikëqyrur.

Në mënyrë të ngjashme, ZSHR kryen revizionin dhe kontrollin financiar në institucionet publike, duke përfshirë edhe aktorët e sektorit të sigurisë, sipas udhëzimeve dhe dispozitave të ligjit për revizion shtetëror. Faqja e internetit e ZSHR-së (www.dzr.gov.mk) përmban raportet vjetore të revizionit të buxhetit qendror, si dhe raportet e përkohshme të revizionit për buxhetin e institucioneve publike, sipas planit vjetor të ZSHR-së. Aktorët e sektorit të sigurisë, si MM, MPB, dhe AI, janë rregullisht nën kontroll të ZSHR-së, dhe raportet mund të gjenden në arkivin e faqes së internetit të ZSHR-së, e cila daton nga viti 2001. Raporti i fundit i Ministrisë së Mbrojtjes ka deklaruar se fondet nga qiratë janë mbledhur dhe raportuar me vonesë për shkak të mungesës së disa të dhënave të kombinuara për disa objekte kapitale që janë në pronësi të ministrisë, si dhe masat e nevojshme për të korrigjuar atë siç është rekomanduar.⁷¹ ZSHR, në faqen e saj të internetit, gjithashtu publikon raportet e rekomandimeve nga raportet e mëparshme të revizioneve në faqen e saj të internetit. Shumica e rekomandimeve, rreth 80%, janë pranuar dhe zbatuar sipas ZSHR-së, që përbëjnë një rekord të fortë të zbatimit.⁷²

Lidhur me transparencën e buxhetit dhe temat lidhur me të, procedurat e buxhetimit maqedonas mund të përmirësohen, sidomos në sektorin e sigurisë. Buxhetet për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme përmbajnë shuma të mëdha për “funksionimin e Armatës së Republikës së Maqedonisë” dhe “funksionimin e Agjencisë së Inteligjencës”, ku nuk shpjegohet në mënyrë të qartë se për çka janë përdorur këto shuma. Kjo është veçanërisht e rëndësishme pasi buxheti tashmë përmban artikuj të veçantë për pajisjet dhe furnizimet, si dhe për pagat, por këto shpenzime nuk janë shpjeguar siç duhet. Kjo lejon ndryshime të pakufizuara të buxhetit për institucionet e sigurisë, siç ka ndodhur në vitin 2008, kur buxheti i UBK arriti deri në 25.000.000 €, pa shpjegime të mëtjeshme apo justifikime. Derisa institucionet kanë të drejtë ligjore për të transferuar fonde të kufizuara nga një në një tjetër linjë buxhetore, kategoritë e buxhetit nuk janë mjaft të qarta për të

71* Годишен извештај 2009г. (Raporti vjetor 2009), Zyra shtetërore e revizionit, 21 korrik 2010

72* Годишен извештај 2009г.

kuptuar për çfarë qëllimesh këto фонде do të përdoren.

C] Kapaciteti administrativ dhe menaxherial

Sikur disa legjislacione primare, që rregullisht i nënshtrohen rishikimit dhe ndryshimit, akte të ngjashme dytësore duhet të ndryshohen dhe miratohen përsëri, gjë që është shpesh një proces i gjatë. Kur të gjitha ligjet e reja janë miratuar (si ligji për revizion shtetëror i vitit 2010) një seri e tërë e akteve të reja nënligjore duhet të miratohet. Ky proces mund të marrë ndoshta një vit, por shpesh edhe më shumë, që nënkupton se puna e sistemit financiar dhe transparenca e tij nuk janë vendosur akoma dhe janë ende në proces të ndryshimeve të shpeshta.

Sa i përket burimeve njerëzore dhe financiare, situata është e ngjashme. Disa institucione shquhen për kapacitetet njerëzor dhe material mjaft të fortë për të zbatuar punën e tyre, si Ministria e Financave, e cila ka një akt sistematizimi prej 700 faqeve dhe më shumë se 700 të punësuar, ose ZSHR, e cila në vitin 1999 ka filluar me vetëm 9 punonjës, por tani ka 93 të punësuar me aftësi të larta, dhe një listë të gjatë me dokumente rreth strategjive, zhvillimit dhe trajnimit. Këto rritje në numrin e punonjësve të kualifikuar, dokumentet strategjike dhe legjislacionet sekondarë tregojnë se si është rritur kapaciteti për të kryer detyrat e tyre, si dhe si është cilësia e shërbimeve që ata ofrojnë.

Nga ana tjetër, disa organe të tjera janë duke u krijuar vetëm pas miratimit të një ligji të ri, si njësi për revizion të brendshëm dhe kontroll financiar të secilit nga përfituesit buxhetor, përfshirë edhe aktorët e sektorit të sigurisë. Numri i njësive të kontrollit të brendshëm është rritur prej 15 në 110 në pesë vitet e fundit, kështu që shumica e institucioneve publike kanë themeluar njësi të kërkuara ligjërisht të revizionit të brendshëm. Lidhur me këtë, edhe pse për fat të keq, përqindja e rekomandimeve të miratuara nga institucionet ka mbetur rreth 50% (54.5% në vitin 2008, 56% në vitin 2007).⁷³ Në vitin 2009 vetëm, 144 revizorë të brendshëm dhe 130 zyrtarë të kontrollit financiar janë punësuar

73* Состојба на системот за внатрешна ревизија. (Gjendja e sistemit të revizionit të brendshëm.) Ministria e Financave. Në dispozicion në: <http://finance.gov.mk/node/564>

në institucionet qeveritare qendrore⁷⁴, dhe edhe pse MM dhe MPB nuk ishin në mesin e institucioneve me personel të pamjaftueshëm, kërkojnë punëtorë plotësues. Këto shifra tregojnë se procesi i krijimit të kapaciteteve në aspektin e kontrollit financiar dhe revizionit nuk është plotësisht i kompletuar.

Sipas ligjit për revizion të brendshëm në sektorin publik (*Gazeta zyrtare* 69/04) dhe ligjit për kontroll të financave të brendshëm publike (90/09), çdo institucion publik duhet të ketë njësi për revizion të brendshëm dhe njësi për çështje financiare poashtu. Këto njësi janë të menaxhuara nga qendra për revizion të brendshëm në MF. Njësitë e revizionit të brendshëm dhe çështjeve financiare, përveç kontrollit financiar, kryejnë revizion mbi harmonizimin e akteve të brendshme me legjislacionin kombëtar dhe interpretimin e efektivitetit dhe të projektit vlera-për-para të institucioneve publike. Raportet e tyre nuk janë publike dhe janë të destinuara të përdoren nga MF dhe Komisionet e MF dhe për revizion dhe kontroll financiar.

Dj Vlerat

Ndryshimet legjislative dhe aktivitetet e krijimit të kapacitetit të përshkruara në paragrafet e mësipërme tregojnë se vetëdija e transparencës financiare është në rritje, të paktën në mesin e disa anëtarëve të elitës politike dhe administrative, që kanë iniciuar këto reforma. Megjithatë, pasi që kapaciteti është ende i dobët, zbatimi i dispozitave ligjore po mbetet pas, vlerat ende duhet të adoptohen në mesin e menaxhuesve dhe atyre që punojnë për institucionet e sektorit të sigurisë.

Siç tregohet në paragrafet e mësipërm, njësitë për revizion të brendshëm janë duke u themeluar kohëve të fundit, dhe duhet të kalojë më tepër kohë derisa të shfaqet një sukses i fortë i buxhetimit.

Nuk është çudi që besimi i publikut dhe perceptimet publike për transparencën financiare janë gjithashtu të mbetur prapa. Besimi i publikut në institucionet financiare është më i ulët sesa besimit në ushtri, gjë që sugjeron se popullata nuk

⁷⁴* Финансиска контрола: дописи и извештаи. (Kontrolli financiar: komunikimi dhe raportet.) Ministria e Financave. Në dispozicion në: <http://finance.gov.mk/node/679>

ka besim, ose nuk është e njohur me transparencën financiare në përgjithësi.⁷⁵ Mirëpo, besimi dhe perceptimet e publikut janë formuar më shumë nga disa skandale financiare dhe nga korrupsioni në polici dhe ushtri, të cilët janë bërë tema të mëdha në media këto vitet e fundit, se sa nga përmbajtja e raporteve të revizioneve dhe transparenca e procesit të buxhetimit.

Nota: 3. Legjislacioni i nevojshëm është miratuar duke përfshirë dispozitat në përputhje me standardet ndërkombëtare të transparencës financiare. Zbatimi dhe kapaciteti janë forcuar kohët e fundit, por nuk ka të dhëna të qëndrueshme rreth praktikës së mirë, si dhe ndryshimet e shpeshta dhe plotësimet parandalojnë përhapjen dhe pranimin e praktikave.

2] Transparenca financiare e furnizimeve publike

A] Legjislacioni

Furnizimet publike menaxhohen nga MF. Në veçanti, Byroja e furnizimeve publike (BFP) është përgjegjëse për rregullimin, mbikëqyrjen dhe drejtimin e procedurave të furnizimeve publike në sektorin publik në Maqedoni. BFP është një institucion qendror, por secili nga institucionet publike, duke përfshirë edhe aktorët e sektorit të sigurisë, ka një person ose njësi përgjegjëse për furnizimet publike. Puna e BFP-së dhe procedurave të furnizimeve publike në përgjithësi është e rregulluar me ligjin për furnizimet publike (*Gazeta zyrtare* 136/07), i cili përcakton llojet dhe procedurat e ndryshme për furnizimet publike dhe siguron që parimet e transparencës, ndër të tjerash, duhet të respektohen.

Institucionet e sektorit të sigurisë janë të lidhura me procedurat e përcaktuara në ligjin për furnizimet publike dhe në listën e legjislacionit sekondar, në dispozicion nga BFP. Çdo institucion publik përgatit një plan vjetor të furnizi-

^{75*} Shiko të dhënat nga Gallup Ballkan Monitor 2009, 2010. Në dispozicion në: <http://www.balkan-monitor.eu/index.php/dashboard>

meve, sipas udhëzimeve nga MF, duke përcaktuar sasinë, natyrën dhe vlerën e mallrave ose shërbimeve që kërkon. Thirrjet e furnizimeve publike janë publikuar sipas planit vjetor, dhe ofertat janë mbledhur dhe vlerësohen sipas kritereve të efikasitetit të përcaktuara me ligj. I vetmi përjashtim i përcaktuar me ligj ka të bëjë me furnizimet publike të mallrave ose punëve të cilat janë të rëndësishme për sigurinë dhe mbrojtjen e shtetit, në të cilin rast procedura e furnizimeve publike nuk i përfill dispozitat e përgjithshme, por informacioni është trajtuar si informacion i klasifikuar. Në raste të tilla, institucionet të cilat kërkojnë procedurë të klasifikuar duhet të informojë qeverinë në fillim të çdo viti në lidhje me llojin dhe sasinë e furnizimeve të këtilla, në mënyrë që qeveria do të mund të zhvillojë procedurën.

Sa i përket transparencës, ligji bazë, si dhe legjislacioni sekondar, janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane të furnizimeve publike. BFP, nëpërmjet faqes së saj të internetit ka vënë në dispozicion ligjet, aktet nënligjore dhe rregulloret plotësuese, duke përfshirë direktivat e BE-së që janë duke u adoptuar në legjislacionin kombëtar, si dhe rregulloret dhe udhëzimet e detajuara në lidhje me procesin e furnizimeve publike. BFP është gjithashtu përgjegjëse për udhëheqjen e Sistemit elektronik të furnizimeve publike (SEFP), i cili lejon transparencë më të madhe gjatë procesit të furnizimeve publike duke i vënë në dispozicion të gjitha dokumentet, duke njoftuar rreth ndryshimeve në thirrjet dhe kërkesat, si dhe duke mbajtur e-ankande. Programi e-furnizim i bën të mundur publikut hyrjen në detajet e thirrjeve të furnizimeve, listën e thirrjeve që çdo institucion ka publikuar dhe ofertuesin fitues të çdo thirrjeje.

B] Zbatimi

SEFP është i vetmi program që lejon qasje të hapur në informata në lidhje me furnizimet publike në institucionet e sektorit të sigurisë. Faqja e internetit e SEFP (e-nabavki.gov.mk) përmban një arkiv 2-vjeçar të thirrjeve të furnizimeve publike dhe të kontratave të përfunduara nga çdo institucion. Çdokush mund të shohë se çfarë lloji dhe sa lloje të thirrjeve dhe kontratave janë përfunduar, të cilat janë kategorizuar në bazë të shumës së kontratës: më pak se 5.000

euro, më pak se 20.000 euro, dhe mbi 20.000 euro.

Nuk ka asnjë statistikë në dispozicion rreth llojeve të thirrjeve të furnizimeve, shumës së tyre, kohëzgjatjes së tyre, ose numrit të ofertuesve që marrin pjesë. MM, MPB dhe IA nuk japin një informacion të tillë, kështu që është e vështirë për publikun për të artikuluar një ide të qartë në lidhje me gjendjen e furnizimeve publike në sektorin e sigurisë. Nëse hedhim një shikim në arkivat e SEFP shohim se lloji më i shpeshtë i furnizimeve është furnizimi i vogël deri në 5.000 euro, për të gjithë, MPB-në, MM-në dhe IA-në, edhe pse Ministria e Mbrojtjes ka furnizime edhe deri në 20.000 euro. Asnjë informacion nuk është në dispozicion në lidhje me furnizimet e klasifikuara, të cilat janë trajtuar si të dhëna të besueshme dhe jo në dispozicion për shqyrtim publik.

Në rast të shkeljes së procedurës ligjore për furnizime publike, ligji cakton gjoba. Raportet e ZSHR-së, se rreth një e katërta e parregullsive lidhur me furnizimet publike, kanë të bëjnë me furnizimet pa thirrje publike, si dhe me një numër të konsiderueshëm të parregullsive gjatë fazës së vlerësimit. Ka pasur raste të shumta të procedurave të padrejta të furnizimeve publike, disa prej të cilave kanë përfunduar në gjykatë. Ministri i Mbrojtjes është marrë në gjyq dy herë për shkelje të procedurave të furnizimeve publike, duke lënë të kuptohet se as personat më të lartë politik nuk janë të imunizuar ndaj ndjekjes penale për akte të paligjshme.

C] Kapaciteti administrativ dhe menaxherial

Shumica e përpjekjeve që synojnë luftën kundër korrupsionit, janë në lidhshmëri me procesin e furnizimeve publike. Prandaj, përmirësimi i transparencës së furnizimeve publike ka qenë një ndër pikat primare në agjendën politike gjatë disa viteve të fundit. Ligji i ri për furnizime publike është miratuar në vitin 2007, dhe legjislacioni përkatës sekondar rishikohet në mënyrë që të përmbushen standardet ndërkombëtare dhe evropiane në këtë fushë. Lidhur me këtë, është vendosur sistemi i furnizimeve elektronike si një program më transparent dhe me qasje më të lehtë, duke ofruar pjesëmarrje më të lehtë në procesin e furnizimeve publike.

BFP në strategjinë e saj të fundit ka vërejtur nevojën për krijimin e kapacite-

teve shtesë në sektorin publik për përmirësimin e punës në procesin e furnizimeve publike. BFP ka planifikuar trajnime dhe vlerësim të punonjësve të furnizimeve publike si në BFP ashtu edhe në institucionet e tjera publike, në mënyrë që të jetë në gjendje që me sukses të zbatojë reformat e nevojshme në këtë fushë.⁷⁶ BFP i është nënshtruar krijimit të kapaciteteve të konsiderueshme në vitet e mëparshme, duke forcuar potencialin njerëzor të saj dhe aftësitë e disponueshme, sidomos në fushën e IT, me qëllim që të jetë në gjendje të udhëheqë reformat e nevojshme.

Institucionet e tjera, duke përfshirë edhe ato të sektorit të sigurisë, kanë mbe-tur prapa kapacitetit të krijuar në MF dhe BFP, dhe kjo ndikon në cilësinë e procesit të furnizimeve publike. Si aktorët më të mëdhenj financiar mes institucio-neve publike në Maqedoni, MF dhe BFP ishin të parët që krijuan kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe administrative në fushën e furnizimeve publike. Institucionet e sektorit të sigurisë gradualisht janë duke forcuar kapacitetin e tyre në lidhje me furnizimet publike.

Dj Vlerat

Sistemi i furnizimeve publike në Maqedoni është kritikuar rëndë gjatë dy dekadave të fundit, si një prej arsyeve për korrupsionin e përhapur gjithandej në të gjithë sektorin publik, por edhe në institucionet e sektorit të sigurisë. Shumë qeveri të njëpasnjëshme kanë premtuar se do të rregullojnë sistemin e furnizimeve publike dhe shumë aktorë ndërkombëtarë, qeveri dhe organizata kanë treguar gatishmëri për të mbështetur reformat e tilla. Edhe pse paragrafet e mësipërme tregojnë se një progres në aspektin e transparencës financiare në sistemin e furnizimeve publike është evident, perceptimi publik i këtyre aktiviteteve të institucioneve publike është mjaft i ulët.

Gjatë viteve, MM dhe MPB kanë qenë të përfshirë në dy skandale të rënda që kishin të bëjnë me korrupsionin gjatë furnizimeve të pjesëve rezervë për artileri (MM), furnizimeve të ushqimit ushtarak gjatë vitit 2001 (MM), si dhe

⁷⁶* Стратегија на Бирото за јавни набавки за развој на системот на јавни набавки 2010-2012. (Strategjia e Byros së furnizimit publik për zhvillimin e sistemit të furnizimit publik 2010-2012). Byroja e furnizimit publik 2010.

furnizimeve të makinave dhe rrobave të policisë (MPB), të cilët kanë dëmtuar imazhin e dy institucioneve në sytë e publikut. Lloji i klasifikuar i furnizimeve publike në sektorin e sigurisë është shtuar në perceptimin publik të këtyre institucioneve, si jo-transparent dhe shpesh i korruptuar.

Zbulimi i shpeshtë i veprimeve të padrejta dhe korruptive të furnizimeve publike në media, tregon se nuk ka të dhëna të veprave të mira, edhe pse disa institucione janë në varësi nga vlerat e tyre institucionale dhe kapacitetet njerëzore dhe organizative.

Nota 3: legjislacioni i nevojshëm themelor dhe sekondar është i harmonizuar me standardet ndërkombëtare dhe të BE-së të kësaj fushe. Zbatimi është i ngadalshëm, edhe pse duke u përmirësuar, siç është edhe kapaciteti administrativ dhe menaxherial i institucioneve të përfshira. Vlerat mungojnë ende dhe sektori i sigurisë, në veçanti, vuan nga reputacioni i keq sa i përket transparencës financiare të furnizimeve publike.

↳ Rekomandime:

Buxheti:

Legjislacioni i buxhetimit duhet azhurnuar në mënyrë që publiku do të jetë më i kyçur në procesin e buxhetimit me anë të kyçjes së buxhetit të qytetarëve.

Roli i parlamentit në mbikëqyrjen buxhetore duhet të forcohet për të kompensuar mungesën e qasjes së publikut në informacionet e buxhetit në fazën përgatitore.

Qeveria duhet të lejojë edhe kontributin e shoqërisë civile në procesin e planifikimit të buxhetit dhe në proceset e revizionit dhe ristrukturimit eventual.

Institucionet e sektorit të sigurisë (MPB, MM, IA) duhet të bëjnë buxhetet e tyre më transparente duke i vënë ato në dispozicion të publikut në faqet e tyre të internetit.

Furnizimi publik

Gjithë sektori publik duhet të bëjë një përpjekje të pandërprerë - duke respektuar ligjin dhe duke ndjekur penalisht mashtrimin – që t'i adoptojë vlerat e transparencës financiare në buxhetim dhe furnizime publike për të fituar besimin e popullsisë dhe për të forcuar kapacitetet institucionale.

Zyrtarët e furnizimeve publike në ministritë dhe organet publike duhet të jenë të trajnuar për të përdorur mjete të avancuara elektronike të furnizimeve publike dhe përdorimi i furnizimeve elektronike duhet të zgjerohet në mënyrë që të përfshijë më shumë lloje të thirrjeve të furnizimeve.

↳ Bibliografia:

Burimet primare:

Устав на Република Македонија (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë).
Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë. Nr. 52. 22.11.1992

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është ndryshuar me amendamentet vijuese: Amendamentet I dhe II (10 janar 1992); Amendamenti III (02 korrik 1998); Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII (20 nëntor 2001); Amendamenti XIX (30 dhjetor 2003); Amendamentet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX, XXX (09 dhjetor 2005)

(Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 52. 22.11.1992

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është ndryshuar me amendamentet vijuese: Amendamentet I dhe II (10 janar 1992); Amendamenti III (02 korrik 1998); Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII (20 nëntor 2001); Amendamenti XIX (30 dhjetor 2003); Amendamentet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX, XXX (09 dhjetor 2005)

Закон за полиција (Ligji për policinë). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 114/2006, 03.11.2006

Закон за одбрана (Ligji për mbrojtje). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 42/2001, 01.06.2001

(Ligji për ndryshimin e ligjit për avokatin e popullit). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 05/03

(Ligji për ndryshimin e ligjit për avokatin e popullit). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 58/2006, 11 maj 2006

(Ligji për ndryshimin e ligjit për avokatin e popullit). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 110/2009, 02 shtator 2009

Закон за Државна ревизија (Ligji për revizion shtetëror). *Gazeta zyrtare e Re-*

publikës së Maqedonisë. Nr. 66/2010, 13 maj 2010

Закон за Државна ревизија (Ligji për revizion shtetëror). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 65/1997, 22 dhjetor 1997

Закон за класифицирани информации (Ligji për informacionet e klasifikuara). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 09/04, 27 shkurt 2004

Закон за јавните набавки (Ligji për furnizimet publike). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 136/07, 12 nëntor 2007

Закон за внатрешна ревизија во јавниот сектор (Ligji për revizion të brendshëm në sektorin publik). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 69/04, 7 dhjetor 2004

Закон за буџетите (Ligji për buxhetet). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 64/2005, 03 gusht 2005

Стратегија на бирото за јавни набавки за развој на системот за јавни набавки (Strategjia e byrosë së furnizimit publik për zhvillimin e sistemit të furnizimit publik 2010 – 2012). Byroja e furnizimit publik 2010.

Burimet nga interneti

Faqja e internetit e Ministrisë së Financave: www.finance.gov.mk

Faqja e internetit e Ministrisë së Punëve të Brendshme: www.moi.gov.mk

Faqja e internetit e Ministrisë së Mbrojtjes: www.mod.gov.mk

Faqja e internetit e Agjencisë së intelegjencës: www.ia.gov.mk

Faqja e internetit e Zyrës së provizionit shtetëror: www.dzr.gov.mk

Faqja e internetit e Byrosë së furnizimit publik: www.javni-nabavki.finance.gov.mk

Faqja e internetit e e-buxhetit: www.e-budget.finance.gov.mk

[Faqja e internetit e Sistemit elektronik të furnizimeve publike:](#)

www.e-nabavki.gov.mk

Rekomandime:

Buxhetimi:

Legjislacioni i buxhetimit duhet azhurnuar në mënyrë që publiku do të jetë më i kyçur në procesin e buxhetimit me anë të kyçjes së buxhetit të qytetarëve.

Roli i parlamentit në mbikëqyrjen buxhetore duhet të forcohet për të kompensuar mungesën e qasjes së publikut në informacionet e buxhetit në fazën përgatitore.

Qeveria duhet të lejojë edhe kontributin e shoqërisë civile në procesin e planifikimit të buxhetit dhe në proceset e revizionit dhe ristrukturimit eventual.

Institucionet e sektorit të sigurisë (MPB, MM, IA) duhet të bëjnë buxhetet e tyre më transparente duke i vënë ato në dispozicion të publikut në faqet e tyre të internetit.

Furnizimi publik

Gjithë sektori publik duhet të bëjë një përpjekje të pandërprerë - duke respektuar ligjin dhe duke ndjekur penalisht mashtrimin – që t'i adoptojë vlerat e transparencës financiare në buxhetim dhe furnizime publike për të fituar besimin e popullsisë dhe për të forcuar kapacitetet institucionale.

Zyrtarët e furnizimeve publike në ministritë dhe organet publike duhet të jenë të trajnuar për të përdorur mjete të avancuara elektronike të furnizimeve publike dhe përdorimi i furnizimeve elektronike duhet të zgjerohet në mënyrë që të përfshijë më shumë lloje të thirrjeve të furnizimeve.

Bibliografia:**Burimet primare:**

Устав на Република Македонија (Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 52. 22.11.1992

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është ndryshuar me amendamentet vijuese: Amendamentet I dhe II (10 janar 1992); Amendamenti III (02 korrik 1998); Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII (20 nëntor 2001); Amendamenti XIX (30 dhjetor 2003); Amendamentet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX, XXX (09 dhjetor 2005)

(Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 52. 22.11.1992

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë është ndryshuar me amendamentet vijuese: Amendamentet I dhe II (10 janar 1992); Amendamenti III (02 korrik 1998); Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII (20 nëntor 2001); Amendamenti XIX (30 dhjetor 2003); Amendamentet XX, XXI, XXII, XXIII, XXIV, XXV, XXVI, XXVII, XXVIII, XXIX, XXX (09 dhjetor 2005)

Закон за полиција (Ligji për policinë). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 114/2006, 03.11.2006

Закон за одбрана (Ligji për mbrojtje). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 42/2001, 01.06.2001

(Ligji për ndryshimin e ligjit për avokatin e popullit). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 05/03

(Ligji për ndryshimin e ligjit për avokatin e popullit). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 58/2006, 11 maj 2006

(Ligji për ndryshimin e ligjit për avokatin e popullit). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 110/2009, 02 shtator 2009

Закон за Државна ревизија (Ligji për revizion shtetëror). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 66/2010, 13 maj 2010

Закон за Државна ревизија (Ligji për revizion shtetëror). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 65/1997, 22 dhjetor 1997

Закон за класифицирани информации (Ligji për informacionet e klasifikuara). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 09/04, 27 shkurt 2004

Закон за јавните набавки (Ligji për furnizimet publike). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 136/07, 12 nëntor 2007

Закон за внатрешна ревизија во јавниот сектор (Ligji për revizion të brendshëm në sektorin publik). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 69/04, 7 dhjetor 2004

Закон за буџетите (Ligji për buxhetet). *Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë*. Nr. 64/2005, 03 gusht 2005

Стратегија на бирото за јавни набавки за развој на системот за јавни набавки (Strategjia e byrosë së furnizimit publik për zhvillimin e sistemit të furnizimit publik 2010 – 2012). Byroja e furnizimit publik 2010.

Burimet nga interneti

Faqja e internetit e Ministrisë së Financave: www.finance.gov.mk

Faqja e internetit e Ministrisë së Punëve të Brendshme: www.moi.gov.mk

Faqja e internetit e Ministrisë së Mbrojtjes: www.mod.gov.mk

Faqja e internetit e Agjencisë së intelgjencës: www.ia.gov.mk

Faqja e internetit e Zyrës së provizionit shtetëror: www.dzr.gov.mk

Faqja e internetit e Byrosë së furnizimit publik: www.javni-nabavki.finance.gov.mk

Faqja e internetit e e-buxhetit: www.e-budget.finance.gov.mk

Faqja e internetit e Sistemit elektronik të furnizimeve publike:

www.e-nabavki.gov.mk

TRANSPARENCA
E SEKTORIT TË SIGURIMIT NË
MAQEDONI

